

1 E martë, 15 mars 2022

2 [Deklaratat përmbyllëse]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 9.30 paradite

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
7 të gjithë.

8 Zonja Sekretare e Gjykatës, ju lutem, thërrisni çështjen.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës.

11 Kjo është çështja KSC-BC-2020-07, Prokurori i
12 Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
14 Tani do bëjmë paraqitjen e palëve.

15 Zonja Bolici.

16 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.
17 ZPS-ja ka të njëjtën përbërje, me përjashtim e vetëm që zoti
18 Whiting nuk është i pranishëm në sallën e gjyqit sot dhe
19 stazhieri që na është bashkuar sot është John Flavin.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
21 Zoti Rees.

22 Z. REES: [Përkthim] Nuk kemi ndryshime.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
24 Zoti Cadman.

25 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kemi ndryshime.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej që zoti
2 Gucati dhe zoti Haradinaj janë të dy të pranishëm në sallën e
3 gjyqit.

4 Sot do të vazhdojmë me deklaratat përmbyllëse me çështjen
5 Prokurori kundër Gucatit dhe Haradinajt.

6 Dje dëgjuam deklaratat përmbyllëse të ZPS-së. Ndërkohë që
7 sot do të fillojmë me Mbrojtjen.

8 Siç u tha edhe dje nga zoti Rees, nga Mbrojtja, pra, zoti
9 Rees do të vazhdojë sot do të flasë për gjatë ditës dhe nesër
10 për ca kohë. Dhe më pas do ta ketë radhën zoti Cadman për
11 Mbrojtjen e tij.

12 Siç u tha dje nga Trupi Gjykses, Mbrojtja duhet të marrë
13 parasysh që pyetjet e Trupit Gjykses duhet të zgjasin nga 30
14 deri në 45 minuta pas çdo deklarate. Në qoftë se është e
15 nevojshme, anëtarët e Trupit Gjykses mund të bëjnë pyetje
16 gjithashtu edhe gjatë parashtrimeve gojore.

17 Përpara se t'ia jap fjalën Mbrojtjes, vërej se Trupi
18 Gjykses ka marrë një provë shtesë të propozuar dje.

19 Zoti Cadman, kam një pyetje. Duket sikur nuk e kemi marrë
20 deklaratën e Emin Kabashit. Ju lutem, a mund ta nxirrni këtë
21 deklaratë deri në mesditë sot?

22 Z. CADMAN: [Përkthim] Po. Do ta bëj edhe sot paradite.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shumë
24 faleminderit.

25 Lidhur me të njëjtën çështje. Në urdhrin e javës që

1 shkoi, ne i kërkuam palëve që të na thonin në fillim të
2 parashtrimeve të tyre lidhur me dënimin në qoftë se palët mund
3 të pajtohen me pikat faktike. Paneli e ndryshon këtë urdhër
4 tani dhe mendon që mund të përgatiten më mirë palët për këto
5 parashtrime të enjten.

6 ZPS-ja për rrjedhojë duhet që të thotë në një email, deri
7 fund të orarit zyrtar sot, në qoftë se është gati që të
8 pajtohet për fakte, për ndonjë nga faktet e këtyre deklaratave
9 dhe në qoftë se pajtohet ose kundërshton pranueshmërinë e
10 deklaratave.

11 Në qoftë se ZPS-ja kundërshton vetëm pjesërisht pranimin,
12 neve do t'u kërkonim palëve që të kenë diskutime *inter partes*
13 dhe të japin një përgjigje deri të enjten.

14 Në varësi të informacionit të ZPS-së, Trupi Gjykues do të
15 japë ca udhëzime lidhur me urdhrin për nxjerrjen dhe trajtimin
16 e deklaratave, e parashtrimeve për dënimin.

17 Zoti Pace.

18 Z. PACE: [Përkthim] Shkurtimisht. Thjesht duam t'ju themi
19 që sot paradite kemi kontaktuar me Mbrojtjen lidhur me
20 dokumentet e nxjerra dje, me synimin e arritjes së një
21 propozimi dhe mezi presim që të angazhohemi në diskutime të
22 mëtejshme *inter partes*. Do t'ju informojmë për çdo zhvillim.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
24 E vlerësojmë shumë nismën.

25 Tani fjala për ju, zoti Rees.

1 Z. REES: [Përkthim] Në çdo proces penal, i pandehuri
2 prezumohet i pafajshëm deri sa të provohet i fajshëm. Siç e ka
3 thënë me të drejtë Prokuroria, fajësia e të akuzuarit duhet të
4 provohet përtej dyshimit të arsyeshëm. Barra e provës i takon
5 Prokurorit të Specializuar dhe kjo barrë prove për fajësinë
6 mbetet me Prokurorinë në të gjithë procesin e gjyqimit. Zoti
7 Gucati nuk duhet të provojë pafajësinë e tij.

8 Sigurisht, që ka dy të pandehur në këtë proces penal dhe
9 përdorimi i etiketimit "të akuzuarit" për t'iu drejtuar në
10 mënyrë të përbashkët zotit Haradinaj dhe zotit Gucati ka si
11 qëllim, në qoftë se nuk është i projektuar, për të çorientuar
12 deklaratat -- për të çorientuar procesin. Ndërkohë që
13 deklarata e Prokurorisë është një prej shembujve ku thuhet që
14 i akuzuari ka thënë këtë, i akuzuari ka thënë atë dhe vetëm
15 përmes vlerësimit të hollësishëm të çdo poshtëshënimi mund të
16 vërtetohet që, në fakt, fjalët kanë të bëjnë vetëm me një prej
17 të akuzuarve. Dhe, në fakt, janë fjalë që cilat janë thënë në
18 mungesë të pranisë së të akuzuarit tjetër. Dhe për rezultat
19 është e rëndësishme që këto gjëra të mund të specifikohen siç
20 duhet nga Prokuroria. Dhe Prokuroria të mos ketë qasjen e
21 përgjithshme apo të bëjë këtë pyetjen e përgjithshme sepse
22 zoti Gucati, ndërmjet kohës nga 7 deri në 25 shtator, pra --
23 domethënë, përgjigja dhe referimi që i është bërë zotit Gucati
24 për këtë element, nuk është i mjaftueshëm sepse përgjigja që
25 ka dhënë zoti Gucati është e qartë. Është e rëndësishme që

1 specifikohet se për çfarë periudhe specifike flitet. A mund --
2 dhe si rezultat provat kundër dhe në favor të secilit prej të
3 akuzuarve janë të ndryshme.

4 Dhe për këtë arsye është e rëndësishme që vlerësimet e
5 këtyre provave ndaj dy të akuzuarve të mund të vlerësohen
6 veçmas. Në emër të zotit Gucati, sigurisht, që unë do të
7 përqendrohem tek çështja e ngritur kundër tij.

8 Zoti Gucati, përballlet me gjashtë pika të Aktakuzës.
9 Sigurisht, çështja e Prokurorisë mbi këto gjashtë pika dhe në
10 qoftë se Prokuroria ka provuar fajësinë përtej dyshimit të
11 arsyeshëm për secilën prej këtyre pikave të Aktakuzës, duhet
12 të vlerësohet veçmas dhe për rrjedhojë edhe vendimet duhet të
13 merren veçmas për secilin prej tyre.

14 Dje, ne u trajtuam dhe na u ofrua një lloj qasje me shumë
15 ngjyra dhe partizane e njëanshme. Ndërkohë që unë,
16 personalisht, do të mundohem që të jap një qasje më të ftohtë
17 për të ulur paksa temperaturën. Dhe dua t'i kujtoj Trupit
18 Gjykues një pjesë të provave të heshtura. Dhe do të doja që të
19 bëj edhe parashtrimet e mia lidhur me këto prova të cilat nuk
20 ishin të dukshme. Dhe, sigurisht, domethënë varet nga
21 vlerësimi juaj, të nderuar anëtarë të Trupit Gjykues. Kështu
22 që unë do të jem më i ftohtë dhe do t'u referohem
23 parashtrimeve të mbështetura në ligj dhe cila është qasja jonë
24 lidhur me propozimin sesi duhet të vlerësohet secila prej
25 këtyre pikave. Këto parashtrime duhet të vlerësohen; por,

1 gjithsesi, është detyra juaj, si Trup Gjykues, që të vlerësoni
2 mbështetur mbi ligjin.

3 Përpara sesa të fillojmë me këtë ushtrim, dua të bëj një
4 koment, nëse më lejoni. Biseda e Trupit Gjykues për të mos e
5 lejuar Gjykatën që të dëshmojë duke mos i dhënë ZPS-së atë
6 çfarë kërkon ZPS-ja, ashtu siç thotë ZPS-ja në paragrafin 2038
7 në parashtrimin tim, me respekt, kjo në vetvete demonstroi
8 mungesën e respektit profesional dhe të vlerësimit të ZPS-së
9 ndaj këtij Trupi Gjykues.

10 Ky është një proces penal. Dhe sukcesi ose dështimi i
11 këtij procesi penal, i këtij gjykimi penal, duhet që të matet
12 vetëm duke ju referuar drejtësisë së procesit në raport me të
13 akuzuarin, me të pandehurin dhe aftësisë për të ofruar respekt
14 dhe dinjitet për të gjithë pjesëmarrësit në procesin gjyqësor,
15 argumenteve të cilat parashtrohen në emër të tyre, aftësinë e
16 saj për të vlerësuar provat, në qoftë se këto prova ofrohen
17 nga njëra palë ose nga tjetra, përmes standardeve të drejta
18 dhe në fund, në qoftë se, pra, duhet që vendimet të jepen në
19 mënyrë të drejtë, të pavarur, të paanshme, mbështetur vetëm
20 tek provat dhe tek analiza objektive e ligjit. Në qoftë se
21 këto vendime të vërteta janë të pavarura, të drejta dhe të
22 paanshme është e rëndësishme që gjykimi të merret mbi
23 vlerësimin e tyre. Në emër të Hysni Gucatit, unë nuk guxoj që
24 ta udhëzoj Trupi Gjykues që të marrë një drejtim të caktuar,
25 ashtu siç u sugjerua nga Prokurori i Specializuar. Po ndërkohë

1 do t'i bëja thirrje Trupit Gjykues që të bëjë vlerësimin e
2 vetë dhe të japë vendimet e veta mbështetur në analizën e
3 ligjit dhe të provave që janë sjellë përpara kësaj Gjykate.

4 Testi i pikave individuale, sa i takon zotit Gucati, që
5 Prokuroria i ka provuar përtej dyshimit të arsyeshëm janë të
6 sajuara. Vetëm provat të cilat janë pranuar gjatë procesit të
7 gjykimit mund të konsiderohen dhe mund të vlerësohen. Për
8 shembull, referenca në dosjen përfundimtare të Prokurorisë në
9 paragrafin 267, është poshtëshënimi 749, te një tjetër
10 deklaratë e bërë nga Prokurori i Specializuar, deklaratë kjo e
11 bërë jashtë Gjykate më 22 shtator 2020 nuk është pranuar si
12 provë, kështu që nuk është me vend që ajo të referohet në
13 dosjen përfundimtare të çështjes dhe sigurisht, që nuk duhet
14 të merret parasysh nga Trupi Gjykues.

15 Në mënyrë të ngjashme, prezumimet e dosjes së Prokurorisë
16 përkatësisht në paragrafin 22, poshtëshënimi 47, sa i takon
17 një postimi në Facebook këto nuk janë prova të cilat janë
18 pranuar në gjykim. Dhe nuk kanë lidhje me pohimin përkatës të
19 Prokurorisë.

20 Dhe, në njëjtën mënyrë edhe në paragrafin 24, pra,
21 personi i cili ka ofruar së pari paketë me informacion nuk
22 është i njohur nga ZPS-ja. Dhe sërish do të doja të
23 referohesha dhe të thoja që ZPS-ja nuk ka bërë parashtrime në
24 këtë gjykim sipas të cilave ky qëndrim i saj është i
25 vërtetuar.

1 Nuk mjafton, në asnjë pikë, që të vërtetohet apo të
2 përcaktohen propozimet e përgjithshme joligjore, propozime të
3 tilla si, për shembull, zoti Gucati ka pasur si qëllimin e
4 vetëm që të minojë apo që të kundërshtojë DHSK-në apo
5 Prokurorin e Specializuar. Nuk mjafton të përcaktohet që
6 propozimi, në një moment të caktuar kohe, zoti Gucati i ka
7 bërë të ditur emrin e një të ashtuquajturit dëshmitar
8 potencial. Sepse kjo është, sipas përkufizimit të ZPS-së, që
9 ky është një person i cili ka informacion rreth një krimi, ose
10 kryesve, ose rrethanave të rëndësishme të cilat kanë të bëjnë
11 me këtë Gjykatë. Sepse, në fund të ditës, në qoftë se do t'i
12 referohemi këtij përkufizimi, të gjithë ne në këtë sallë i
13 përmbushim elementet e këtij përkufizimi. Nuk mjafton po ashtu
14 për asnjë pikë që të përcaktohen propozimet që ka dhënë
15 Prokuroria edhe disa çështje historike të cilat ka përmendur
16 Prokuroria, janë çështje të cilat kanë ndodhur 10, 15 vjet
17 vite më përpara dhe që kanë të bëjnë me vështirësi me
18 dëshmitarë të cilët, në mënyrë të përbashkët, kanë çuar në një
19 frymë frikësimi të dëshmitarëve në Kosovë. Asnjë prej këtyre
20 propozimeve të përgjithshme të cilat janë përsëritur herë pas
21 here nga Prokuroria, nuk janë të mjaftueshme për qëllimet
22 tona.

23 Tani më lejoni, që të filloj me një temë, temë e cila kjo
24 e ka përshkruar të gjithë procesin e gjykimit dhe që është
25 shumë e rëndësishme, ne parashtrojmë këtë pikë tonën, lidhur

1 me kuptimin e provave dhe kjo ka të bëjë me shqetësimin e
2 zotit Gucati, që ka të bëjë me drejtësinë selektive,
3 përzgjedhëse. Kjo është temë e cila ka përshkruar të gjithë
4 këtë proces gjykimi sepse, siç thotë zoti Gucati, motivimi i
5 tij, qëllimi i tij që është demonstruar përmes veprimeve dhe
6 fjalëve të tij në shtator të vitit 2020.

7 Janë bërë kritika që ai ka shprehur pikëpamjet që Dhomat
8 e Specializuara janë monoetnike ose që i është referuar asaj
9 si raciste dhe ka folur gjithashtu edhe për bashkëpunimin e
10 saj me Serbinë. Në deklaratën hapëse, Prokurori i Specializuar
11 në mënyrë të veçantë njohu të drejtën për të kritikuar Dhomat
12 e Specializuara. Në faqen 787 të transkriptit, në rreshtat 4
13 dhe 6, Prokurori i Specializuar thotë:

14 "Është në rregull nuk ka ndonjë problem që të thoni që ka
15 gjëra që nuk i pëlqeni rreth kësaj Gjykate dhe është në
16 rregull që të thoni pse nuk e pëlqeni këtë Gjykatë. Kjo është
17 pjesë e një shoqërie të lirë".

18 Por, në këtë pikë zoti Gucati e ka shprehur shqetësimin e
19 tij për Gjykatën dhe në fakt, arsye objektive për të
20 mbështetur këtë qëndrim ose pikëpamje të tija pavarësisht nga
21 fakti në qoftë se jeni dakord me të apo jo. Dhe, siç e kemi
22 parë nga provat, përfshirë këtu edhe shumë anëtarë të shtypit
23 në Kosovë, ndajnë të njëjtën pikëpamje. Zoti Gucati, ka bërë
24 thirrje për drejtësi për të gjithë, jo për drejtësi për ca.

25 A mund të pyes, ju lutem, që të shfaqet prova materiale

1 P29-ET, që të tregohet në ekran.

2 Nëse, të nderuar Gjykatës, do të shikoni në fund të kësaj
3 faqeje, do shohim në paragrafin në fund fare, në kohën
4 përkatëse 00:01:59, ku zoti Gucati thotë që:

5 "Ne nuk jemi kundër drejtësisë, por jemi kundër
6 drejtësisë selektive, drejtësisë përzgjedhëse".

7 Kjo përmbledh në mënyrë të pastër pozicionin e zotit
8 Gucati dhe shqetësimet e tij lidhur me këtë gjykim. Mbështetja
9 e tij për drejtësi për të gjithë, është një pozitë, është një
10 qëndrim, që ai e ka shprehur si gjatë periudhës së Aktakuzës
11 dhe në fakt edhe përpara kësaj periudhe.

12 A mund të shohim, ju lutem, provën materiale P83-ET, në
13 faqen 57. Ju lutem, shfaqni edhe versionin anglisht të së
14 njëjtës provë.

15 Faqen 57 apo 87, pra, këtu mund të shikojmë një postim,
16 më datë 18 korrik, ku thuhet:

17 "E gjithë bota di për krimet që ka bërë shteti serb në
18 fund të shekullit të 20-të në disa vende të Ballkanit. E ftoj
19 Viola Von Cramon, një deputete e Parlamentit Evropian që të
20 vijë në Kosovë së afërmi që të shohë krimet barbare që kanë
21 kryer ndaj shtetit serb [sipas përkthimit]. Por, tani në vend
22 që sot të dënohen kriminelët serbë për krime dhe dhunën e
23 madhe që kanë kryer në Kosovë, sot po gjykohet lufta e drejtë
24 e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe e popullit të Kosovës.
25 Viola Von Cramon e ftoj dhe në Organizatën e Veteranëve të

1 Luftës së UÇK-së t'i tregoj për të gjitha krimet e kryera nga
2 shteti serb. I bëjmë thirrje eurodeputetes Cramon të mos
3 ndërhyjë në punët e Gjykatës Speciale nëse vërtetë dëshiron që
4 të vendoset drejtësia. Atëherë të vijë dhe t'i shohë të gjitha
5 krimet barbare të kryera nga forcat serbe në Kosovë”.

6 Ndërkohë komenti më poshtë thotë:

7 “I bëjmë thirrje deputetes Viola Von Cramon për të gjitha
8 krimet e kryera në Kosovë nga forcat e shtetit serb të ngrejë
9 zërit për themelimin e Gjykatës së Veçantë Speciale që do të
10 dënonte Serbinë si shtet për krimet barbare që ka kryer shteti
11 serb”.

12 Dhe ne jemi për krijimin e një gjykate që heton të gjitha
13 krimet e kryera, në periudhën përkatëse, pra, për të gjitha
14 palët.

15 Tani, ju lutem, le të shikojmë provën P9-ET, faqja 8,
16 këtu, më 7 shtator tani, në fillim të periudhës së Aktakuzës:

17 “Siç kemi thënë, katër-pesë vitet e fundit, ne jemi
18 kundër Gjykatës Speciale. Nuk jemi kundër drejtësisë, po
19 kundër Gjykatës Speciale...” sepse ka një qasje selektive.

20 Zoti Haradinaj, në prani të zotit Gucati, e ka mbështetur
21 këtë thirrje për drejtësi për të gjithë.

22 Në faqen 5, nga 15, në qoftë se shikoni nën 00:14:21, në
23 paragrafin e dytë nën të, do të shikoni se Haradinaj thotë që
24 të zgjerohet mandati i Gjykatës dhe atë thotë që:

25 “... duhet të propozohet që të amendohet ligji dhe të

1 bëhet një propozim që Gjykata të ndjekë penalisht të gjitha
2 krimet. OVL UÇK-ja nuk është kundër zgjidhjes së krimeve; në
3 fakt e mbështet këtë”.

4 Është një pozicion që ata e kanë paraqitur vazhdimisht.

5 A mund të shikojmë, ju lutem, P12-ET. Përsëri e njëjta
6 datë. Shkoni në faqen 5, ju lutem. Në krye të faqes, këtë herë
7 është zoti Tomë Gashi, por që në prani të zotit Gucati, thotë:

8 “Zyrtarët e OVL UÇK-së, duke përfshirë edhe kryetarin e
9 saj, Hysni Gucati dhe të tjerët, po kërkojnë që të zhbëhet
10 Gjykata Speciale përmes mjeteve ligjore. Në qoftë se kjo del e
11 pamundur, në qoftë se kjo është e pamundur për shkak të
12 marrëveshjeve ndërkombëtare që ekzistojnë, atëherë ata
13 kërkojnë një zgjidhje alternative normale. Ky është një hetim
14 që po bëhet nga serbët dhe nuk duhet t’i ndajmë krimet serbe
15 nga ato shqiptare, por t’i hetojmë të gjithë ata që kanë bërë
16 krime gjatë luftës.

17 “Ne e dimë që 15,000 shqiptarë civilë janë vrarë gjatë
18 luftës nga forcat pushtuese serbe, policia serbe dhe nga
19 ushtarët, paramilitarët e tyre dhe mbi bazën e këtij ligji ata
20 nuk ndiqen penalisht aspak. Mendoni pak për këtë. Kjo do të
21 thotë që Dhomat e Specializuara, që është e vetmja gjykatë
22 ndërkombëtare që po heton krimet e luftës në Kosovë, nuk
23 merret me krimet e kryera nga serbët dhe kjo është katastrofë.
24 Ata thuhet se po hetojnë krimet kundër njerëzimit, por nuk po
25 hetojnë krimet kundër njerëzimit dhe tmerret dhe gjenocidin që

1 kanë bërë forcat serbe këtu për shumë vite kundër shqiptarëve
2 si entitet kombëtar”.

3 Pra, Prokuroria përqendrohet dhe përjashton çdo gjë
4 tjetër, heq fjalë të caktuara dhe merr vetëm ato fjalë në të
5 cilat do të mbështet. Prokuroria fokusohet se “zoti Gucati dhe
6 të tjerët duan të zhbëhet Gjykata përmes mjeteve ligjore”. Por
7 ata nuk marrin parasysh kontekstin, që e ka thënë vazhdimisht
8 zoti Gucati gjatë kësaj procedure, që ai kërkon dhe ata
9 kërkojnë që të bëhet një gjykatë që heton të gjitha krimet.
10 Nuk janë kundër drejtësisë.

11 Dhe zoti Gucati përsëri thotë, po të shikojmë P28-ET.

12 Në faqen e parë të kësaj interviste më 22 shtator në
13 rreshtat 14 deri në 16, ju lutem:

14 “Për sa i përket drejtësisë dhe neve, ne jemi për një
15 drejtësi të drejtë, të ndershme dhe jo për një drejtësi
16 selektive apo të njëanshme”.

17 Dhe po kështu në faqen 11 të të njëjtës intervistë, duke
18 filluar nga rreshti 28, ai i bëri thirrje kësaj Gjykate,
19 konkretisht edhe Prokurorisë, që të hetojnë një çështje të
20 caktuar. E ka përmendur dhe herë të tjera, të nderuar
21 Gjykatës, siç mund t’ju kujtohet. Por këtë ne e shohim në
22 rreshtin 28:

23 “Unë e kam përmendur dhe në një program tjetër sot, në
24 një debat që patëm me një avokat që quhet ‘Peç Panda’, rastin
25 e atij që quhet ‘Peç Panda’, unë besoj se e dini atë...

1 “.. për gjashtë serbë që u vranë, që ishin qytetarë të
2 Kosovës, ishin serbë, ishin fëmijë, sepse vetëm fëmijë ishin
3 kur u vranë, ishin 15 deri në 17 vjeç. Pse nuk e heton këtë
4 Gjykata Speciale? Sepse Gjykata Speciale heton krimet që ka
5 bërë UÇK-ja kundër serbëve”.

6 Dhe kur gazetari ngriti çështjen e juridiksionit, zoti
7 Gucati vuri në dukje që:

8 “Edhe ata janë qytetarë të Kosovës. Ata janë qytetarë të
9 Pejës. Pse nuk i konsideron Gjykata Speciale ata si qytetarë
10 të Kosovës dhe të shikojë, të shqyrtojë çështjen e tyre?
11 Pavarësisht se janë serbë, ata janë qytetarë të Kosovës, pse
12 nuk e shikojnë këtë çështje? Pse nuk merren me këto çështje
13 aspak?”

14 Ai donte hetimin e të gjitha krimeve. Ishte një pozicion
15 që e përmendi edhe e përsëriti edhe kur dha dëshmi. Mund të
16 shikojmë transkriptin e dëshmisë të zotit Gucati në faqen
17 T2412. Në rreshtin 25, ai tha kështu:

18 “Unë thashë që jam kundër kësaj Gjykate dhe vazhdoj të
19 jem kundër kësaj Gjykate sepse kjo Gjykatë nuk na bind se
20 është në gjendje të hetojë krimet që janë kryer në Kosovë.
21 Krimet që kanë bërë policia dhe çetnikët serbë që kanë vrarë
22 gjashtë civilë serbë. Këtë kam thënë dhe i qëndroj kësaj. Në
23 qoftë se kjo Gjykatë heton krimet në mënyrë jodiskriminuese, e
24 theksoj këtë jodiskriminuese, vetëm nga ajo pikë e tutje do të
25 jem në gjendje që ta mbështesë këtë Gjykatë”.

1 Ai vazhdoi përsëri, në faqen 2428, në faqen 15.

2 "... kjo Gjykatë Speciale që është ngritur për të -- kjo
3 Gjykatë speciale që është ngritur duhet të ndjekë edhe krimet
4 e kryera nga serbët dhe nga Serbia. Dhe nuk e mendoj që është
5 e drejtë dhe e barabartë kjo lloj drejtësie. Unë nuk dua të
6 bëj asnjë fajtor këtu, po ata po bëjnë punën e tyre, por ata
7 duhet ta bëjnë punën e tyre në një mënyrë të drejtë dhe të
8 barabartë".

9 Këto nuk janë sofizma nga zoti Gucati. Sigurisht, i takon
10 Trupit Gjykses që të vlerësojë zotin Gucati si njeri, si
11 dëshmitar, por një gjë që nuk mund ta mendonit për zotin
12 Gucati është që ai është një njeri i sofistikuar. Ai përpigjet
13 që të flasë sa më qartë dhe drejtpërdrejtë që të jetë e
14 mundur. Ai është kritikuar se ka përdorur fjalën
15 "bashkëpunëtor" "kolaborator" ose "kolaboracionist". A mund
16 t'i kujtoj Gjykatës që duhet të kushtojë kujdes kur e shikon
17 këtë fjalë. Në anglisht ka dy fjalë "kooperim" dhe "kolaborim"
18 kurse në shqip ka një fjalë të vetme, që është fjala
19 "bashkëpunoj" dhe nuk ka dallim midis bashkëpunimit si
20 kooperim dhe bashkëpunimit si kolaborim. Por kjo është një
21 fjalë që ai e përdori në përgjigje të pyetjes të Gjykatësit
22 Mettraux.

23 Në transkriptin faqja T2433.

24 Në rreshtin 13, Gjykatësi Mettraux, mbasi bëri një
25 diskutim me zotin Gucati për qasjen, nëse mund ta quajmë

1 kështu, për mbështetjen apo jo të kësaj Gjykate, ju e pyetët:

2 "Kur thatë në televizion që ju doni ta minoni këtë
3 Gjykatë, duhet ta kuptojmë këtë se ju donit t'i jepnit
4 këshilla kësaj?"

5 Përgjigja e tij:

6 "Kështu është, i nderuar Gjykatës, unë dua ta këshilloj
7 jo ta minoj dhe ta shkatërrojë atë, po që të japë këshilla që
8 të mos bashkëpunojë me kriminelët e luftës po me njerëzit që
9 janë dëshmitarë të fakteve. Dhe unë jam mbështetës i zjarhtë i
10 drejtësisë. Dhe që nga kjo pikëpamje unë kam qenë kundër kësaj
11 Gjykate".

12 Dhe këtë pozicion, ai e ka shprehur vazhdimisht, ndoshta
13 jo dhe në mënyrë aq elegante por shumë qartë, që kundërshtimi
14 i tij bazohet në shqetësimin që ka ai se kjo Gjykatë, kjo
15 Prokurori, nuk po heton të gjitha krimet e luftës që janë
16 kryer gjatë asaj kohe.

17 Sigurisht, si pjesë e kësaj ai ka shprehur edhe
18 shqetësimin, ashtu siç e shprehu dhe në këtë pasazh, që
19 Prokuroria është marrë me ato që i përshkruan ose ka pasur
20 marrëdhënie me ato që i përshkruan, zyrtarë famëkeq serbë.
21 Njerëz që janë përshkruar edhe këtu në Gjykatë, po edhe në
22 artikuj të gazetave në shtyp - që kanë qenë persona që kanë
23 marrë pjesë në masakra gjatë luftës së Kosovës. Dhe Gjykatësi
24 Mettraux e ngriti çështjen dhe e ngriti këtë kur dha dëshmi
25 zoti Robert Reid, por kjo nuk është në vetvete as unike, nuk

1 është në vetvete as e kundërshtueshme për një hetim që të
2 kërkojë bashkëpunimin e personave që janë të dyshuar për
3 kryerje krimesh; madje edhe krime të rënda.

4 Dhe në faqen T3364 të transkriptit, Gjykatësi Mettraux e
5 pyeti zotin Reid në lidhje me këtë. Në rreshtin 2, ju e
6 pyesni:

7 "... në praktikën dhe përvojën tuaj, në Australi apo në
8 Tribunalin e Hagës, a ka ndodhur që keni marrë informacion nga
9 individë që kishin dyshime se kanë kryer krime?"

10 Dhe ai ju përgjigj:

11 "Po. Në disa raste dhe kjo ishte një nga vështirësitë që
12 kemi pasur dhe në disa raste ne hetonim një kryes ose një grup
13 kryesish dhe kishim një grup viktimash. Por, pastaj, kishte
14 një ekip tjetër që hetonte viktimat që ishin grupi kryes dhe
15 viktimat ishin grupi tjetër kryes".

16 Në qoftë se më kuptoni se çfarë po them, pastaj në
17 rreshtin 12 ai vazhdon:

18 "Dhe kjo ndodhi disa herë, kur kryesit jepnin prova apo
19 jepnin informacion, ne e vërtetonim atë që kishin thënë ata
20 dhe e konfirmonim dëshminë që kishin dhënë ata, nëse ishte e
21 vërtetë apo jo".

22 Dhe disa nga rastet më përfaqësuese të kësaj janë kur të
23 akuzuarit të cilët u vetëdeklaruan fajtorë dhe pastaj dhanë
24 dëshmi kundër komandantëve të tyre. Dhe, pastaj, për ta kjo
25 duhej të vërtetohej në shkallën më të lartë me shumë persona

1 të tjerë. Pra, sigurisht, nuk është unike dhe nuk është as
2 diçka e kundërshtueshme e paparë që Prokuroria të shkojë, t'i
3 qaset personave që mund të dyshohen të kenë kryer krime.

4 Por, ka një dallim në përgjigjen që dha zoti Reid këtu
5 dhe situatës që kemi ne, sepse zoti Reid foli aty për hetimin
6 e një grupi kryesish, ku ke një grup viktimash dhe pastaj një
7 ekip tjetër që hetonte krimet që ishin grupi kryes për ta.
8 Dhe, në fakt, ai flet për ndjekjen e atyre që dyshoheshin që
9 kishin krime, nëse jepnin apo bashkëpunonin, jepnin dëshmi apo
10 bashkëpunonin me ta apo jo, se këtu dha që shembujt më të mirë
11 ishin kur të akuzuarit kishin thënë, që ishin vetëdeklaruar,
12 fajtorë dhe duke pasur parasysh, sigurisht, pasojat e
13 veprimeve të tyre dhe dhanë informacion kundër personave të
14 tjerë të cilat pastaj duhet të vërtetoheshin në shkallën e
15 dytë, të tretë e kështu me radhë.

16 Pra, ka një dallim midis kësaj që thotë zoti Reid që ka
17 hasur ai dhe procesit të drejtë dhe të balancuar ku nuk ka
18 imunitet, ku të dyja palët hetohen plotësisht dhe informacioni
19 vërtetohet në shkallën më të lartë dhe ata që kryejnë krime,
20 nëse bashkëpunojnë apo jo, duhet të përballen me pasojat e
21 veprimeve të tyre. Është ky dallim, pra fakti, që ky proces i
22 barabartë dhe i balancuar nuk mund të ndodhi këtu dhe ky mos-
23 hetim i të gjitha palëve, siç kishte bërë zoti Reid në rastin
24 e tij, është pikërisht kjo ajo që ngre zoti Gucati si
25 shqetësim.

1 Sigurisht, është pjesë e ligjit mbi të cilin janë ngritur
2 Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar
3 që i jep Prokurorisë autoritet shumë të madh për të hetuar
4 provat dhe të marrë provat në Kosovë, në territorin e Kosovës,
5 pa u mbështetur në bashkëpunimin e autoriteteve kosovare,
6 megjithatë, kjo nuk e bën shqetësim më të vogël këtë.
7 Prokurori i Specializuar siç e dini në bazë të ligjit ka
8 mundësinë për të thirrur, për të pyetur personat, për të
9 mbledhur informacione gjatë fazës së arrestimit dhe të hetimit
10 brenda Kosovës. Ai ka kompetencat e policisë, ka të njëjtin
11 autoritet dhe të njëjtin përgjegjësi si dhe policia e Kosovës
12 brenda territorit të saj. Ligji kërkon që ZPS-ja të veprojë në
13 mënyrë të pavarur krahasuar me autoritet e Kosovës, por nuk
14 specifikon të njëjtën gjë për Serbinë.

15 Punonjësit, ndërtesat dhe pasuritë që ajo ka në
16 dispozicion i gëzojnë imunitet dhe privilegje në Kosovë, pra,
17 ato që i përkasin ZPS-së. Urdhrat që lëshojnë Dhomat e
18 Specializuara hyjnë në fuqi vetëm në territorin e Kosovës. Një
19 fletë-arrest i lëshuar nga Dhomat e Specializuara ka të njëjtën
20 fuqi dhe efekt si ato që lëshohen nga Gjykatat e Kosovës. Dhe
21 Dhomat e Specializuara kanë përparësi për sa i përket
22 juridiksionit të tyre të posaçëm mbi të gjitha gjykatat e
23 tjera të Kosovës. Ka fuqinë për të transferuar tek Dhomat e
24 Specializuara dhe Prokurori i Specializuar të gjitha
25 procedurat dhe hetimet por vetëm që i përkasin Kosovës.

1 Që kjo është pjesë e caktuar e ligjit, që është kaq
2 përzgjedhës dhe selektiv, nuk e bën atë që të mos jetë
3 shqetësuese apo pa vlerë. Dhe nga ana tjetër siç kemi parë kjo
4 është dhe një pikëpamje e cila është e ndarë edhe me shumë
5 njerëz të tjerë, përfshirë shtypin. Kjo kornizë ligjore është
6 e qartë që është hartuar për të bërë të mundur që ZPS-ja mund
7 të kërkojë bashkëpunimin me autoritet e Kosovës por nuk është
8 e detyruar ta bëjë një gjë të tillë dhe mund të veprojë në
9 mënyrë të njëanshme brenda territorit të Kosovës.

10 Nuk ka arsye, ndërkohë, që mandati i kësaj Gjykate është
11 për të hetuar krime të bëra gjatë luftës së Kosovës, luftë
12 ndërmjet shtetit serb apo një luftë agresive e ndërmarrë nga
13 shteti serb në Kosovë, që ky mandat t'i trajtojë ndryshe
14 autoritet kosovare dhe serbe. Sistemi i drejtë do të ishte ai
15 i cili të kishte të njëjtat kompetenca ligjore për të vepruar
16 në Serbi, si dhe në Kosovë. Dhe duke qenë që ZPS-ja nuk i ka
17 këto kompetenca, sipas mendimit tonë dhe këtë e ka thënë edhe
18 zoti Gucati dhe mjaft njerëz të tjerë në Kosovë, përfshirë
19 anëtarët e shtypit, që ky është një deficit i madh apo një
20 mangësi e madhe për sa i përket mandatit të Prokurorit të
21 Specializuar.

22 Prokuroria nga ana tjetër është e ndërvarur nga
23 bashkëpunimi i Serbisë për të hetuar serbët, për të hetuar
24 krimet e bëra gjatë luftës së agresionit apo agresive të
25 ndërmarrë nga Serbia në territorin e Kosovës [e kjo] bën që

1 ZPS-ja dhe hetimet që ajo ndërmer në Serbi të jenë të
2 manipuluar apo të ketë ndërhyrje që i manipulojnë. Zoti
3 Gucati, përpara Aktakuzës dhe më pas, e ka shprehur këtë frikë
4 të manipulimit të dëshmive si rezultat i hetimeve të ndërmarra
5 nga autoritetet serbe në Serbi. Kjo nuk është një frikë të cilën
6 e ka vetëm zoti Gucati. E kanë edhe mjaft të tjerë, siç kemi
7 dëgjuar, përfshirë edhe pjesëtarë të medias, të shtypit.

8 Të shohim tani faqen 7-ET.

9 Gjatë kësaj interviste gazetari, e ju kërkoj ndjesë për
10 shqiptimin, po është zonja Osmanaj, 00:44:42 shpreh mendimin e
11 qartë që:

12 "... Beogradi njihet që fabrikon fakte".

13 Kjo është një përmbledhje e bukur e një qëndrimi i cili
14 ka ekzistuar gjatë të gjithë kohës në Kosovë. Një frikë që
15 Prokurori i Specializuar dhe Dhomat e Specializuara për shkak
16 të mungesës së kompetencave për të hetuar në Serbi dhe për
17 shkak se janë të detyruar që të bashkëpunojnë me Serbinë për
18 të bërë hetime në Serbi bën që rezultati i këtyre hetimeve të
19 jetë në një farë mënyre i ndikuar nga manipulimi. Që është një
20 pikëpamje mbizotëruese.

21 Është ironike në fakt që përpjekjet e një zyrtari serb,
22 për shembull, për të fabrikuar fakte, siç thotë zonja Osmani,
23 bën që përpjekjet për të ndryshuar kursin e drejtësisë të
24 Dhomave të Specializuara nga zyrtarët serbë, në fakt, i japim,
25 i bëjnë, i çojnë në pandëshkueshmëri, që është një shqetësim

1 që zoti Gucati e ka shprehur dhe të tjerët e ndajnë, përfshirë
2 anëtarët e shtypit.

3 Serbia, siç e dimë ne, nuk e njeh pavarësinë e Kosovës
4 dhe Kushtetutën e Kosovës, Kuvendin e Republikës së Kosovës
5 dhe siç e dimë edhe sot e kësaj dite, Serbia, pavarësisht
6 realitetit, thotë që ajo është autoriteti drejtues në
7 territorin e Kosovës.

8 Një strukturë e drejtë dhe e pavarur ligjore duhet të
9 ishte njohur edhe nga Serbia dhe nga Kosova. Ajo duhet t'i
10 kishte dhënë mundësinë ZPS-së të kishte të njëjtat kompetenca
11 për të vepruar në mënyrë të njëanshme në Serbi dhe në Kosovë
12 dhe t'i kishte hetuar të gjitha krimet e bëra gjatë luftës
13 agresive të 1998-2000 të bërë nga Serbia, pavarësisht
14 etnicitetit të kryerësve.

15 Kjo qasje selektive përzgjedhëse që është pjesë e
16 brendshme e mandatit të ZPS-së, që del si rezultat i ligjit, e
17 neni 1(2) dhe 6(2) e shprehin qartë që kjo përqasje është
18 përzgjedhëse për shkak të mungesës së kompetencave të ZPS-së
19 në Serbi. Kjo është e qartë, nuk shpjegon, pavarësisht se në
20 fakt pasqyrohet nga përzgjedhja selektive që ka marrë ZPS-ja
21 për sa i përket interpretimit të ligjit në këtë çështje. Është
22 një përzgjedhje selektive që ka çuar në arrestimin dhe
23 procedimin e këtyre dy të akuzuarve, në të njëjtën kohë, kur
24 ata thonë që të njëjtën gjë për sa i përket zotit Klinaku dhe
25 Tomë Gashi në Aktakuzë dhe të tjerët të cilët, në fakt, kanë

1 kryer vepër penale, dhe disa, në fakt, kanë ardhur përpara
2 kësaj Gjykate. Dhe kjo përzgjedhje demonstron jo vetëm për
3 sa u përket procedimit të zotit Gucati dhe në fakt, të zotit
4 Haradinaj në këto rrethana, por në të njëjtën mënyrë paraqet
5 këtë përzgjedhje selektive edhe për sa i përket marrëdhënieve
6 me shtypin.

7 Zoti Halil Berisha dha dëshmi këtu. Dhe në fillim,
8 përpara avokatit të zotit Berisha, më 26 tetor 2021, ZPS-ja
9 tha që zoti Berisha nuk ka bërë krime dhe Prokurori i
10 Specializuar nuk do ta hetonte për atë që mund të kishte bërë
11 për sa i përket apo në kuadrin e kësaj çështjeje.

12 Të shohim transkriptin në faqen 1507. Në rreshtin 6, [z.
13 Halling] konfirmoi në seancë të hapur, pra, [se ai] do të
14 bënte të qartë:

15 "...në bazë të autoritetit të Zyrës së Prokurorit të
16 Specializuar që nuk do ta ndiqte penalisht këtë dëshmitar. Nga
17 natyra e kësaj nuk janë bërë krime sipas mendimit tonë".

18 Dje u bë e qartë e njëjta gjë. Zoti Halling nuk ndryshoi
19 mendim dje gjatë seancës mbyllëse.

20 Për sa i përket interpretimit të gjerësishëm nga ana e
21 ZPS-së të fushëveprimit të pikës 5 të Aktakuzës, për sa i
22 përket zotit Gucati. Sipas këtij interpretimi, ZPS-ja kërkon
23 që ta gjejë fajtor zotin Gucati në pikën 5, fajësia është e
24 përcaktuar nga ana e punonjësve të ZPS-së, jo e atyre që nuk
25 janë punonjës të ZPS-së, sipas tyre nga të qenit në dijeni se

1 një dokument i ZPS-së është konfidencial.

2 Për sa i përket zotit Gucati, ZPS-ja ka interpretimin më
3 të gjerë të fushëveprimit të pikave të Aktakuzës, sidomos për
4 sa i përket identitetit dhe të dhënave personale të
5 dëshmitarëve. Dhe, për sa i përket zotit Gucati. Çdo njeri që
6 nuk është punonjës i ZPS-së, është fajtor për këtë vepër
7 penale, thjesht, për nxjerrjen e çdo emri të një personi
8 tjetër i cili ndodhet në një dokument të ZPS-së, duke e ditur
9 që ky është një person i cili mund të ketë informacion lidhur
10 me një krim-kryes apo rrethana që kanë të bëjnë me procedura
11 përpara kësaj Gjykate. E, siç e përsëris, sipas këtij
12 përkufizimi, kjo mund të ngrihej kundër çdonjërit prej nesh
13 brenda kësaj salle.

14 Asnjë interpretim për sa i përket pikës 5 dhe 6, që mund
15 të jetë e saktë, për shkak se zoti Berisha nuk ka bërë vepër
16 penale, siç e thotë Prokurori dhe ne jemi dakord me të dhe,
17 atëherë, duhet -- ja vlen të shqyrtohet e gjithë sjellja e
18 ligjshme që ka demonstruar zoti Berisha.

19 Më datën 7 shtator 2020, zoti Berisha mori pjesë në
20 konferencën e shtypit te zyrat e OVL UÇK-së së bashku me
21 kameramanin dhe tha që aty ishin dokumentet e Dhomave të
22 Specializuar.

23 Të shohim tani provën T1517 apo transkriptin në T1517,
24 rreshti 16.

25 Zoti Berisha ishte i pranishëm tek zyrat e OVL UÇK-së,

1 siç mund të shihet aty.

2 "Ata treguan ishte -- thanë që ishte e pavarur [sipas
3 përkthimit]. Nuk kishin pritur që t'i sillnin këto dokumente,
4 po ishin dokumentet e sjellë në mëngjes, ishin këto dokumente
5 të cilat ishin të paraqitura në këtë konferencë shtypi.

6 "Për çfarë flitej në këto dokumente?

7 "Siç u tha, në këto dokumente, ato ishin dokumente që
8 vinin nga Dhomat e Specializuara".

9 Zoti Berisha që në fillim tha që këto ishin dokumente të
10 Dhomave të Specializuara.

11 Faqen 1523 të transkriptit, rreshti 16.

12 Kur ishte i pranishëm në zyrë, ai pa që disa prej këtyre
13 faqeve - dhe kjo shihet mes rreshtave 16 dhe 19. Që të paktën
14 [në] disa prej faqeve shihej shenja "konfidencial". Kameramani
15 i zotit Berisha filloj t'i kopjonte këto dokumente me
16 fotografim digjital, ndërkohë që ata ishin të pranishëm tek
17 zyra.

18 Të shohim tani 1584, në rreshtin 10.

19 Kameramani, një njeri me shumë përvojë, që kishte përvojë
20 shumë më të gjatë se zoti Berisha, filloi të incizonte
21 dokumentet.

22 "Si të gjithë kameramanët e tjerë me përvojë të cilët
23 fotografojnë apo marrin filmojnë".

24 Dhe më poshtë në faqe.

25 Zonja Sekretare, mund të zbresim më poshtë.

1 Në fund të kësaj faqeje, ai filloi të bënte kopje të
2 këtyre dokumenteve.

3 Vazhdojmë.

4 Është e vështirë për të treguar sesa dokumente ka filmuar
5 kameramani brenda zyrave. Vështirë, pra, për të dhënë shifrën
6 e saktë të dokumenteve. Por mund të shihet që kjo zgjati rreth
7 10 deri në 15 minuta, siç shihet në rreshtat 20 dhe 21, pra,
8 periudha gjatë të cilit kameramani po i bënte fotografi
9 digjitale këtyre dokumenteve.

10 Në rreshtin 25. T1585, në rreshtin 25. Në fund të faqes
11 thotë:

12 "Ju kërkuat që t'i merrnit këto dokumente me vete apo
13 jo?"

14 Ai tha:

15 "... po ishte problematike. Ishin shumë këto
16 dokumente..."

17 Në faqen tjetër.

18 Dhe kërkoi nëse mund të merrte me vete disa prej tyre për
19 të parë se për çfarë bëhej fjalë dhe mori sipas tij, tha, një
20 numër të madh dokumentesh.

21 T1521, tani në këtë transkript, rreshti 2:

22 "Është vështirë të dihej numri i faqeve."

23 Por është një numër shumë i madh. Është rreth një mijë,
24 ky ishte vlerësimi i tij. Në T1587, në rreshtin 22, ai
25 konfirmoi se po të kishte qenë në gjendje do i kishte marrë të

1 gjitha dokumentet.

2 "Është me të vërtetë që do i kishe marrë të gjitha
3 dokumentet po të kishe patur mundësi?"

4 Përgjigje:

5 "Po".

6 T1588, në faqen tjetër. Në të njëjtën faqe tek rreshti 4,
7 thotë që ajo çfarë dëshironte ai të bënte ishte që të shikonte
8 këto dokumente, të cilat ishin të shënuara si dokumente
9 konfidenciale. Dhe që të kalonte ca kohë duke i shqyrtuar ato.
10 Pra, ai tha që:

11 "Donte që t'i shikonte këto dokumente sepse ishte bërë e
12 mundur që ata të mund t'i shikonin këto dokumente në mënyrë që
13 të mund të kontrollonte dhe të shihte se çfarë mund të
14 raportonte lidhur me to".

15 Në fakt, ai fizikisht i ka marrë dokumentet.

16 Dhe në qoftë se mund të shkojmë tek faqja tjetër, ju
17 lutem. T1522, tek rreshti 21, në këtë pjesë, ai përshkruan
18 sesi i mori dokumentet dhe tha që ishin rreth 2 kilometra më
19 tej. Domethënë, i morri dhe i dërgoi në zyrat e *inFokusit* që
20 gjendeshin rreth 1 kilometër e gjysëm deri në 2 kilometra më
21 larg ndërtesës së OVL-së dhe më pas ja dha këto dokumente
22 anëtarëve të tjerë të shtypit dhe ndërkohë që kanë qenë
23 anëtarë të tjerë të shtypit ato të cilët ja kanë nisur, ja
24 kanë transmetuar këto dokumente personave të tjerë.

25 Në qoftë se do të shikojmë faqen 1572. Në fillim të

1 faqes, në rreshtin 1 thuhet:

2 "Redaktorët dhe unë i pamë këto dokumente për të parë se
3 çfarë kishin brenda [në] ato..."

4 Pra, në zyrat e OVL-së së UÇK-së, ai kishte parë që disa
5 prej këtyre dokumenteve ishin të shënjuar si konfidenciale.
6 Por, në fakt, i kishte marrë të gjitha dokumentet. Dhe ia
7 kishte treguar katër personave të tjerë të shtypit që nuk
8 ishin të pranishëm në zyrat e OVL UÇK-së por ishin në zyrat e
9 gazetës *inFokus*, gazetës së tij, ku këto dokumente ai i
10 prezantoi, i bëri të disponueshme për të tjerët dhe ftoi katër
11 gazetarë të tjerë që t'i lexonte në format të paredaktuar të
12 këtyre dokumenteve.

13 Në qoftë se do shohim faqen 1598, ju lutem, rreshti 3.

14 Pra, njëra prej çështjeve që ishin të interesuar ata
15 ishin për të parë në qoftë se dokumentet do të hidhnin dritë
16 se kush i kishte sjellë dokumentet dhe nga kishin ardhur
17 dokumente. Dhe në rreshtin 7, ai tha:

18 "Për kohën që këto dokumente janë diskutuar, ne jemi
19 marrë edhe me këtë çështje".

20 Pra, kjo është njëra ndër gjërat ose ndër elementët.

21 Tani le të shikojmë pak dokumentin 1597, transkriptin në
22 faqen 1597, ju lutem. Rreshti 21.

23 Pra, nga rreshti 21 deri tek 24, konfirmohet që
24 dokumentet që i ka marrë nga OVL UÇK-ja dhe i ka ndarë me
25 katër anëtarë të tjerë, pra, a ishin këto dokumentet që ju i

1 keni marrë mbrapsht me vete. Ato ishin siç i kishit marrë në
2 të njëjtën formë, në të njëjtin format, qysh i kishit marrë
3 nga OVL UÇK-ja.

4 Tani le të kalojmë tek faqja 1607, rreshti 21.

5 Më vonë janë bërë redaktime digjitale, por kjo ka ndodhur
6 pasi i ka çuar dokumentet në zyrën e tij dhe pasi dokumentet
7 janë ndarë me kolegët e vet të ekipit redaktues. Dhe këtë gjë
8 e specifikon që kjo ka ndodhur pasi dokumentet janë ndarë me
9 ekipin e gazetës.

10 Ndërkohë që në faqen tjetër vijohet:

11 "... që me ekipin editorial dokumentet ishin në formatin
12 e tyre të paredaktuar. Ndërkohë që redaktimet janë bërë më
13 vonë. Më vonë, kur vendosëm se çfarë të botonim, vendosëm
14 gjithashtu se çfarë pamjesh do të botonim së bashku me
15 tekstin".

16 Dhe gjithashtu i referohet faktit që askush nuk kishte
17 një rol specifik për vendosjen ose për bërjen e redaktimeve.

18 Ndërkohë që dokumentet po shqyrtoheshin me ftesë të zotit
19 Berisha në zyrat e *inFokusit*, janë bërë kopje të tyre.

20 Nuk e di në qoftë se mund të shikojmë dokumentin në faqen
21 e transkriptit T1591, në rreshtin 1.

22 Pra, dokumentet, në qoftë se e mbani mend, ishin
23 shpërndarë në një tryezë në një dhomë të madhe, këto ishin
24 shpërndarë nga zoti Berisha në mënyrë që t'iu lejonte
25 anëtarëve të tjerë të shtypit të pranishëm aty në zyrat e

1 *inFokusit* që t'i lexonin këto dokumente. Janë bërë dhe
2 fotografi nga tryeza e madhe dhe kjo tryezë e madhe është në
3 zyrën kryesore, në mes të zyrës, e me zyrën e hapur.

4 "Dhe fotografitë e dokumenteve, të cilat janë shpërndarë
5 dokumentet, duhet të jenë bërë në të njëjtën ditë sepse ajo ka
6 që në dita kur ne kemi parë dokumentet".

7 Në qoftë se do të shikojmë dokumentin T1263, rreshti 9,
8 ai nuk mund të përjashtonte se, pas kësaj dite, mund të ishin
9 bërë kopje të tjera të dokumenteve.

10 "Pra, thuhet, që me sa dini juve, nuk dini në qoftë se
11 janë bërë kopje të tjera, por nuk e përjashtoni këtë mundësi
12 se nuk keni qenë 24 orë në ditë apo jo?"

13 Përgjigja është:

14 "Po e saktë. Nuk e përjashtojë këtë mundësi sepse kishte
15 persona të tjerë që kishin qasje në atë dhomë".

16 Çfarë përmbanin dokumentet e paredaktuara që zoti Berisha
17 ia u dha katër anëtarëve të tjerë të ekipit? Në qoftë se mund
18 të shohim faqen e transkriptit T1572, ju lutem. Rreshti 6:

19 "Ndërkohë që po shfletonim dokumentet", thotë ai "ne pamë
20 që kishte shumë korrespondencë ndërmjet Task Forcës Speciale
21 me prokurorët në Serbi dhe ata kërkonin ofrimin e dëshmitarëve
22 prej tyre, gjithashtu dhe emrat dhe adresat e tyre, Task Forca
23 Speciale nuk mund të verifikonte adresat e tyre.

24 "Domethënë bëhet fjalë për korrespondencë ndërmjet
25 serbëve dhe Task Forcës Speciale për gjetjen e adresave të

1 dëshmitarëve për të cilët ishin të interesuar prokurorët”.

2 Pra, zoti Berisha kishte marrë fizikisht dhe i kishte
3 dërguar në një vend që ishte 2 kilometra më tej vendit nga ku
4 ishin marrë dokumentet, dokumente të paredaktuara dhe që ku
5 kishte parë që disa prej këtyre dokumenteve ishin të shënjuar
6 me shkrimin konfidencial. Pra, ai tha, përpara nesh, që ai i
7 ka treguar, i ka shpërndarë këto dokumente me katër persona të
8 tjerë në zyrë, i ka shpërndarë këto dokumente në një tryezë të
9 madhe në mes të zyrës dhe se ai dhe të tjerët kishin parë që
10 kishte shumë korrespondencë ndërmjet Task Forcës Speciale dhe
11 Prokurorisë së Serbisë, ku Task Forca i kërkonte Serbisë që
12 t’i jepte emrat dhe adresat që kishte marrë Task Forca dhe
13 kërkon, pra, gjetjen e këtyre dëshmitarëve dhe të adresave të
14 tyre.

15 Dhe kjo, sipas ZPS-së dhe, ne jemi dakord me këtë, pra,
16 kjo në vetvete nuk çon tek vepra e nxjerrjes së informacionit
17 sekret në kuadrin e procedurave penale. As nuk vlerësohet,
18 sipas vlerësimit të ZPS-së, por edhe sipas vlerësimit tim, tek
19 nxjerrja e identiteteve të dhënave personale të dëshmitarëve
20 të mbrojtur.

21 Zoti Berisha bëri një dallim midis gjërave ose
22 dokumenteve që nuk ishin konfidenciale brenda dokumenteve dhe
23 elementëve që ishin konfidenciale apo sekret.

24 Le të shohim transkriptin në faqen T1570, rreshti 12, ju
25 lutem.

1 Siç mund ta lexojmë nga përgjigja që ai ka dhënë në
2 rreshtin 12, ai kishte dyshime, siç kishin dhe kolegët e tij,
3 lidhur me vërtetësinë e këtyre dokumenteve. Pra, këto ishin
4 dyshime. Dyshime, të cilat i ka shprehur edhe zoti Gucati dhe
5 kemi dëgjuar dhe të tjerë që i kanë shprehur të njëjtat
6 dyshime. Megjithatë, ai vijon duke thënë:

7 "...ne vendosëm që pavarësisht nga dyshimet, që do të
8 botonim vetëm ato gjëra të cilat nuk ishin konfidenciale, pra,
9 nuk do të botonim gjëra të cilat ishit konfidenciale dhe
10 sekrete".

11 Pra, bëhet dallimi në dokumente që ka parë ai, midis
12 dokumenteve të cilat ishin të shënjuara si konfidenciale, por
13 që ishin përgjithësisht dokumente të cilat kishin të bënin me
14 kërkesat të TFHS-së, të ZPS-së, kërkesa drejtuar Prokurorisë
15 serbe për emrat dhe adresat e dëshmitarëve dhe ata i panë, i
16 shqyrtuan dhe njëherë këto dokumente, i këqyrën ato dhe
17 vendosën që të bënin botimin e dokumenteve që nuk ishin
18 konfidenciale dhe sekrete. Pra, bëhet një dallim i tillë nga
19 ai: Pra, kishte ca gjëra në këto dokumente të cilat ishin
20 konfidenciale, po kishte dhe gjëra të cilat nuk ishin
21 konfidenciale.

22 Ai bën një tjetër dallim të mëtejshëm. Ju lutem, shfaqni
23 transkriptin në faqen T1605. Rreshti 11.

24 Ai bëri dallimin midis personave të cilët ishin persona
25 publikë, të tillë si zyrtarët serbë dhe persona që janë

1 persona privatë. Pra, ai po fliste në mënyrë të veçantë për
2 interesin publik lidhur me botimin e artikujve. Do t'i kthehem
3 këtij argumenti pak më pas. Por për këtë qëllim dua që të
4 tërheq vëmendjen tuaj tek dallimi që bën ai ndërmjet zyrtarëve
5 publikë dhe privatë. Ai thotë:

6 "Ishte në interesin publik që të bëhej kjo gjë sepse këta
7 ishin persona zyrtarë të lartë serbë dhe kishte persona që
8 disa njerëz në Kosovë i njihnin për shkak të deklaratave të
9 tyre. Domethënë këta nuk ishin persona privatë. Dhe përderisa
10 ata përmendeshin në këto dokumente, ne e pamë të arsyeshme që
11 t'i botonim ata, si edhe identitetet e tyre".

12 Pra, kemi dy dallime të bëra deri tani: pra, gjëra të
13 cilat ishin konfidenciale dhe gjëra që nuk ishin
14 konfidenciale; emrat e personave që ishin persona publikë të
15 tillë si zyrtarët serbë dhe persona të tjerë të cilët
16 kategorizoheshin si persona privatë.

17 Dua, ju lutem, të shfaqni tani dokumentin T1609, për një
18 tjetër dallim. Rreshti 10.

19 Ai bëri dallimin ndërmjet dokumenteve të shënjuara si
20 konfidenciale dhe ato të cilat nuk ishin të shënjuara si
21 konfidenciale. Do i shikojmë këto dokumente pas një çasti,
22 megjithatë, në këtë pjesë të transkriptit ai thotë që sa i
23 takon fjalëve "Kosovë dhe Metohi", që nuk është termi korrekt
24 dhe i saktë. Dhe nuk është termi i saktë.

25 "Dhe këto janë terma të cilat përdoren në një dokument

1 ose deklaratë të zyrtarëve serbë dhe që ky dokument nuk ishte
2 shënjuar si dokument konfidencial”.

3 Kështu që e botoi këtë dokument. Pra, dallimi i parë,
4 gjërat që ishin konfidenciale në dokument dhe gjërat që nuk
5 ishin konfidenciale; dallimi i dytë, persona të cilët ishin
6 përmendur në dokumente që ishin persona publikë, si për
7 shembull, zyrtarët serbë dhe personat privatë; dallimi i
8 tretë, disa dokumente të shënuara si konfidenciale dhe
9 dokumente të tjera të cilat nuk ishin të shënjuara si
10 konfidenciale.

11 Edhe, ne, sigurisht, që e dimë që ai ka bërë një tjetër
12 dallim që është dallimi i katërt, dallimi ndërmjet vënies në
13 dispozicion të versionit të paredaktuara të anëtarëve të
14 shtypit, në dallim me botimin e dokumenteve online. Domethënë
15 ngarkimin e dokumenteve online në mënyrë të tillë që të mund
16 të lexohej nga publiku. Pra, ky është dallimi i katërt që
17 është bërë prej tij sepse ai i ka treguar dokumentet, pra, ua
18 ka treguar të gjitha dokumentet siç ishin pa redaktuar
19 kolegëve të vet, por pastaj ka bërë dallimet 1, 2 dhe 3 dhe
20 mbështetur në të vendosi se çfarë të botonte online për
21 publikun por, versioni, domethënë, nuk ishte versioni që ai u
22 kishte vënë në dispozicion katër anëtarëve të shtypit.

23 Por çfarë botoi ai online? Ju lutem, a mund të shohim
24 fletën e transkriptit P125, faqja 4. Pra, bëhet fjalë për
25 provë materiale dhe versioni i plotë i këtij dokumenti është

1 P125-ET-2. Është versioni në shqip dhe në anglisht i
2 përkthyer.

3 Mund të shohim që ai ka botuar imazhe ose foto të
4 dokumenteve në të majtë të ekranit dhe kjo ka ndodhur më datën
5 7 shtator 2020, në orën 14.39.

6 Nuk e di në qoftë se mund ta kaloni pak faqen më poshtë
7 në versionin në gjuhën shqipe. A mund të shohim pak përmendjen
8 e - në fjalinë e parafundit - është fjala "bashkëpunimi", që
9 është e përkthyer në versionin në anglisht që kemi përpara si
10 bashkëpunim, "cooperation" në anglisht, pra, ndërmjet hetuesve
11 të Speciales dhe dëshmitarëve serbë.

12 Pra, ai ka raportuar që dokumentet dëshmojnë bashkëpunim
13 të hetuesve të Speciales me dëshmitarë dhe zyrtarë serbë. Ky
14 informacion nga dokumentacioni nuk ishte informacion
15 konfidencial. Por ai ishte, sipas tij, në interes të publikut
16 që të botohej se për çfarë bënin fjalë këto dokumente.

17 Sërisht të njëjtën datë, më datë 7 shtator, pak kohë më
18 pas, ai ka botuar një tjetër dokument, pra, një tjetër
19 artikull.

20 Nuk e di në qoftë se mund shikojmë versionin e provës
21 materiale 127 dhe pastaj versionin në anglisht të të njëjtës
22 prove që mban shifrën P125-ET-1.

23 Këtu shikojmë një pamje të një dokumenti. Duket si
24 kërkesë koordinimi.

25 Po të kalojmë poshtë në faqen në shqip, në faqen tjetër

1 vazhdo. Dhe shohin, faqen e dytë, që është kërkesë për
2 koordinim që i drejtohet zotit Vukçeviç nga David Schwendiman,
3 data 11 qershor 2015. Dhe aty janë bërë tre redaktime, tre
4 heqje teksti. Këtu janë hequr numrat e referencës në krye dhe,
5 gjithashtu, numri i referencës i një çështjeje gjyqësore.

6 Pjesa tjetër e dokumentit është e botuar e plotë dhe mund
7 të shihet nga përkthimi në anglisht që, faktikisht, teksti i
8 asaj letre është i dhënë i plotë në artikull. Titulli është:
9 "Si ka kërkuar gjykata Speciale prova nga Serbia kundër Adem
10 Jasharit, Hashim Thaçit, Sami Lushtakut, Rexhep Selimit dhe të
11 tjerët".

12 "Gazeta *inFokus* ka siguruar prova që tregojnë se TFHS-ja
13 nën kuadrin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dyshohet se
14 ka kërkuar prova dhe dëshmi nga Serbia kundër Adem Jasharit,
15 Hashim Thaçit, Sami Lushtakut, Rexhep Selimit e të tjerëve.

16 "Ndër mijëra faqe të tjera të siguruara nga gazeta
17 *inFokus* është dhe një letër që Prokurori udhëheqës David
18 Schwendiman i kërkoi dokumente në Serbi nga Vladimir Vukçeviç
19 ish-prokuror për krime lufte. Duke u nisur nga koordinimi i
20 vazhdueshëm i zyrës sonë dhe takimi i jonë i mbajtur më 1
21 qershor 2015, me respekt ju kërkohet që zyra juaj të na
22 furnizojë me kopje të rasteve që kanë të bëjnë me terrorizëm
23 nga grupet e organizuara të armatosura të kryera nga
24 shqiptarët e Kosovës në periudhën 1981-1999, duke përfshirë
25 edhe veprat penale të kapitullit 5 në Kodin Kriminal të

1 Republikës Federative të Jugosllavisë. Ne kërkojmë dokumente
2 në vijim... Për më shumë, me mirësi ju kërkojmë nëse është e
3 mundur që dokumentet e para duhet të rrinë në lidhje"

4 Dhe pastaj është kjo pjesa e redaktuar.

5 "... gjykohen nga Gjykata e Distriktit të Prishtinës ndaj
6 personave në vijim Besim Ramaj, Idriz Aslani, Azem Jashari,
7 Jakup Nura, Fadil Kadriu, Nuredin Lushtaku, Sahit Jashari,
8 Hashim Thaçi, Sami Lushtaku, Rexhep Selimi dhe të tjerë. Kjo
9 thuhet "në këtë dokument që ka siguruar gazeta *inFokus*".

10 Dhe pastaj jepet fotoja me këto tre redaktime të vogla që
11 janë bërë letrës por që jepet e plotë pjesa tjetër.

12 Këtu janë zbatuar ato dallimet që bëri zoti Berisha, ai
13 ja dha të gjithë dokumentin të paredaktuar anëtarëve të
14 shtypit në zyrën e *inFokusit* dhe pastaj pa që ky dokument nuk
15 ishte konfidencial, nuk kishte shenjë konfidencial. Faktikisht
16 nuk kishte. Materiali brenda aty nuk ishte konfidencial. Dhe
17 përmendej emri i Vukçeviçit sepse ai ishte person publik dhe
18 jo privat.

19 Dhe kur e bëri këtë dhe ZPS-ja është dakord me këtë dhe
20 ne jemi dakord me këtë, që nuk ka që ai nuk ka kryer asnjë
21 vepër penale në nxjerrjen e këtij materiali dhe nuk ka kryer
22 asnjë vepër penale kur ka nxjerrë identitetet e atij personit
23 publik dhe nuk kanë nxjerrë identitetet dhe të dhënat
24 personale të dëshmitarëve të mbrojtur dhe Prokuroria është
25 dakord me këtë.

1 Atë e pyetën se pse i botoi ato. Dhe po të shikojmë faqen
2 e transkriptit 1612, në rreshtin 7, u pyet:

3 "Pse ishte kjo, si mendoni ju, pse ishte kjo, sipas
4 mendimit tuaj, në interesin publik?"

5 "Po, në atë kohë ishte Aktakuza kundër ish-presidentit
6 Hashim Thaçi dhe personave të tjerë që po përmendej por ende
7 nuk ishte konfirmuar Aktakuza.

8 Por ai vazhdon të thotë që:

9 "... ishte thënë që po kërkoheshin informacione kundër
10 heronjve të Kosovës dhe heroit Adem Jashari. Dhe kur e pamë
11 këtë në këto dokumente, ne menduam, që kjo ishte në interesin
12 publik që ta dinin sepse Adem Jashari, në atëkohë, ishte vrarë
13 nga forcat serbe. Dhe besoj që qytetarët e Kosovës prisnin që
14 të mblidheshin prova kundër atyre që kishin vrarë Adem
15 Jasharin dhe jo për Adem Jasharin".

16 Pra, po ndaloj këtu. Ai po përsërit atë shqetësim që
17 kishte zoti Gucati, që e kanë përmendur dhe të tjerët në këtë
18 gjykim, dhe është i njëjti mendim që ka edhe zoti Berisha, i
19 njëjti shqetësim që ka dhe zoti Berisha për drejtësi
20 selektive.

21 "Ne prisnim që të mblidheshin prova kundër atyre që vranë
22 Adem Jasharin dhe jo kundër Adem Jasharit".

23 Pra, ai në faqen tjetër vazhdoi dhe tha këtë në rreshtin
24 19. E pyetën se pse e kishte cituar letrën drejt për së drejti
25 dhe pse ishte kjo në interes publik. Ai u përgjigj:

1 "Adem Jashari dhe 50 anëtarët familjes së tij, përfshirë
2 edhe foshnja, u masakruan nga forcat serbe. Prandaj, si
3 qytetarë dhe gazetarë, presim që provat të mblidheshin kundër
4 atyre që kryen këtë masakër dhe ishte shumë e çuditshme për ne
5 që fakte dhe prova po mblidheshin kundër Adem Jasharit në
6 kontekstin e terrorizmit të organizuar dhe terrorizmit të
7 armatosur".

8 Pra, në thelb të kësaj, të shqetësimit të zotit Gucati,
9 është ky shqetësim për qasjen selektive ndaj drejtësisë që ka
10 TFHS-ja dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar.

11 Pas botimit të këtyre dy artikujve, zoti Berisha i dërgoi
12 një email ZPS-së më 7 shtator dhe pastaj dhe më vonë, ku i
13 pyeti për këtë informacionin që ishte çuar tek OVL UÇK-ja. Ai
14 në atë email tha që kishte një kopje të dokumenteve vetë.

15 Ta shikojmë këtë në P98.1.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Rees,
17 mbas kësaj do të bëjmë pushimin, në qoftë se është një pikë e
18 volitshme për të ndaluar.

19 Z. REES: [Përkthim] Emaili i 7 shtatorit në orën 16.26
20 minuta. Dhe këtu, shikoni, mbasi përshkruan shkurtimisht atë
21 që kupton se çfarë janë këto dokumente, natyrën e tyre, aty ka
22 dy pyetje në fund. Ai dëshironte të dinte nëse ZPS-ja kishte
23 dijeni dhe a do të dëmtonin këto hetimet e ZPS-së dhe nëse
24 ZPS-ja po hetonte këtë rrjedhje dokumentesh dhe çfarë do të
25 ndodhte në qoftë se do të botoheshin dokumentet e

1 paredaktuara, në qoftë se, pra, këto dokumente të paredaktuara
2 do të botoheshin nga organet e shtypit.

3 Ai nuk thotë këtu që kishte një kopje të tyre vetë, por
4 ai e tha, shumë publikisht, që e kishte. Sepse e pamë në
5 artikujt e mëparshëm që ai kishte nxjerrë online, domethënë,
6 ato tufat e dokumenteve që të cilat -- fotografi të tyre të
7 cilat ishin shpërndarë në tavolinë dhe, në të dytin, ai botoi
8 këtë kërkesën për koordinim të punës.

9 Ka edhe një artikull tjetër. Po për këtë do të flasim
10 mbas pushimit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
12 zoti Rees.

13 Do të bëjmë pushim tani.

14 --- Pauza fillon në orën 11.01

15 --- Seanca rifillon në orën 11.31

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni ju
17 lutem.

18 Mund të vazhdoni z. Rees.

19 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. Berisha pastaj botoi dhe një artikull tjetër që e kemi
21 në dokumentin 1D2, është edhe P129. Po ta shikojmë thjesht tek
22 1D2-shi sepse është më e lexueshme si kopje, faqja 61 nga 67
23 faqe.

24 Dhe nëse ju kujtohet të nderuar Gjykatës, ky version mban
25 datën e asaj kohe kur z. Berisha po jepte dëshmi. Po ta

1 shikojmë këtu kohën, orën edhe datën mund të shikojmë 7
2 shtator 2020 dhe ora 17:08. Dhe po të kalojmë poshtë në
3 dokument shikojmë që ka fotografinë - ndaloheni pak këtu - të
4 një kërkesë për koordinim numër 33 [sipas përkthimit]. Kjo
5 është e plotë, e paredaktuar. I drejtohet z. Vukçeviç.

6 "Në bazë të koordinimit në vijim si midis zyrave tona, ju
7 lutem gjeni këtu një listë të personave që TFHS-ja do të dojë
8 të intervistojë si dëshmitarë.

9 "Do të isha mirënjohës nëse zyra jua jep adresat,
10 numrat e telefonit dhe të dhënat e kontaktit sepse besohet që
11 këta kanë kërkuar karta identiteti rezidence apo shtetësi
12 serbe.

13 "Po kështu ju kërkoj kopje të të gjitha deklaratave të
14 mëparshme që kanë dhënë këta individë tek autoritetet serbe.

15 "Dhe mirëpres bashkëpunimin tonë në të ardhmen."

16 Dhe në fund të faqes këtu është -- përmendet një shtojcë,
17 listë e dëshmitarëve. E mban datën 24.09.2014. Po vetë kjo
18 letër nuk është e shënuar si konfidenciale.

19 Dhe në qoftë se - mund të kalojmë një çikë më poshtë -
20 ndaloni pak këtu - mund të shikohet që kemi një pamje. Është
21 kërkesë koordinimi nr. 120, që është e botuar nga z. Berisha,
22 online. Dhe këtu duket se ka detaje të tre personave, të cilat
23 janë hequr, si edhe janë hequr pjesë nga paragrafi i
24 parafundit. Por letra është botuar pa redaktime. Këtu thotë:

25 "I dashur z. Vukçeviç.

1 "Në bazë të bashkëpunimit në vijim si midis zyrave tona,
2 TFHS-ja kërkon ndihmën tuaj për të gjetur dhe për të dhënë të
3 dhënat e kontaktit për individët që janë në tabelën më poshtë.
4 Sipas informacionit që kemi që kemi ne, këta individë tani
5 banojnë në Kosovë, por megjithatë gjatë tre viteve të fundit,
6 ata i kanë dhënë informacion zyrtarëve të MUP-it, pra
7 [REDAKTUAR] në Jagodinë."

8 Dhe pastaj është letra me emrat e redaktuar.

9 Letra vazhdon:

10 "Përveç kësaj, TFHS-ja kërkon një kopje të deklaratës të"
11 dhe është pjesë e hequr "2015 që lidhet - si dhe deklaratat që
12 lidhen me," e redaktuar që është "zhdukur nga" e redaktuar
13 "dhe mirëpres bashkëpunimin tonë në të ardhmen."

14 Pra, kjo ashtu siç letra me numër, kërkesa e koordinimit
15 numër 63, kërkon bashkëpunimin e autoriteteve serbe dhe aty
16 pastaj janë hequr pjesët - janë hequr pjesët ku flitet për
17 persona privatë. Pjesa tjetër e letrës nuk është
18 konfidenciale, sepse nuk është shënuar si konfidenciale dhe
19 pjesën jokonfidenciale të letrës ai e ka botuar të plotë, duke
20 përfshirë edhe detajet e zyrtarit publik serb [REDAKTUAR]
21 në Jagodinë.

22 Dhe po të kalojmë edhe në faqen 64, një letër tjetër e
23 botuar me artikullin - këtu nuk kemi redaktime - është një
24 letër për z.[REDAKTUAR], që është kryetari i grupit të punës.
25 Kështu thuhet titulli - këtë titull i jep ai vetes në letër.

1 Dhe në krye të letrës shikoni, ka në krye: Republika e
2 Serbisë, Asambleja Kombëtare, Komiteti në Kosovë dhe Metohi,
3 Grupi i Punës për Mbledhje të Fakteve dhe të Provave për të
4 Hedhur Dritë mbi Krimet e Kryera Kundër Personave Serbë dhe
5 Personave të Tjerë të Komuniteteve të Tjera Etnike në Kosovë
6 dhe Metohi. Data 15 nëntor 2015 [sipas përkthimit], dhe i
7 dërgohet TFHS-së.

8 "I nderuar zotëri/zonjë.

9 "Dua t'ju njoftoj se Komiteti për Kosovën dhe Metohinë,
10 në takimin me 19 tetor, ka krijuar me një vendim Grupin e
11 Punës për Mbledhjen e Fakteve dhe Provave për të Hedhur Dritë
12 mbi Krimet e Kryera Kundër Anëtarëve të Komunitetit Serb dhe
13 Komuniteteve të Tjera Etnike në Kosovë dhe Metohi.

14 "Grupi i Punës...

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mos lexoni
16 emrin që është në këtë. Ju lexuat emrat e tjerë që ishin në
17 letrat e tjera. Edhe ato do të redaktohen. Këta emra mesa dimë
18 ne janë të mbrojtur. Fakti që ju mendoni se ato nuk janë emra
19 të mbrojtur, persona të mbrojtur, kjo nuk do të thotë që ne
20 kemi marrë një vendim të tillë.

21 Z. REES: [Përkthim] Sigurisht unë do bëj ashtu si thoni
22 ju.

23 Letra vazhdon dhe përmend krijimin e marrëdhënieve dhe
24 bashkëpunimin e suksesshëm që ka për qëllim hedhjen dritë mbi
25 krimet e të ashtuquajturës UÇK. Dhe është nënshkruar kryetari

1 i grupit të punës.

2 Kjo letër e botuar e plotë nga z. Berisha në artikullin e
3 tij. Pra këto tre letra të botuara në përputhje me dallimet që
4 i ka bërë ai; dhe ne themi në mënyrën e duhur, dallimet midis
5 gjërave që ishin konfidenciale dhe jokonfidenciale. Ato që
6 ishin shënuar si konfidenciale, dallimin midis personave
7 publikë dhe personave privatë dhe dallimin midis dokumenteve
8 të shënuara konfidenciale dhe atyre që nuk janë të shënuara si
9 konfidenciale, si kjo letër nga kryetari i grupi të punës; dhe
10 dallimin midis vënies në dispozicion të dokumenteve të
11 paredaktuara, të plota për katër anëtarët e trupit - më falni
12 - e shtypit në Zyrën e *inFokus-it* dhe botimin e tyre online,
13 pasi u redaktua materiali konfidencial që përmbanin ato dhe u
14 botua pjesa tjetër.

15 Kur e botoi atë artikull ai nuk ka bërë ndonjë vepër
16 penale duke paraqitur apo duke botuar materiale të
17 autorizuara. ZPS-ja bie dakord me këtë. E ka botuar këtë
18 artikull së bashku me këto tre letra, përfshirë emrin e
19 kryetarit të grupit të punës dhe nuk ka bërë ndonjë vepër
20 penale duke paraqitur në mënyrë të paautorizuar të dhënat e
21 dëshmitarëve të mbrojtur. ZPS-ja dhe ne biem dakord. Dhe ka
22 shpjeguar se pse e botoi këtë artikull dhe të shohim në
23 transkript T1603, rreshti 20.

24 Z. REES: [Përkthim] Ai tha për botimin e këtij artikulli
25 të tre letrave, pra të cilat u botuan në tërësi -

1 Z. REES: Botuar në tërësi me emrat e personave publikë
2 dhe jo privatë, ai tha:

3 "Ne menduam që ishte në interesin publik duke patur
4 parasysh të shkuarën e kombit tonë, të popullit të Kosovës.
5 Ndoshta unë jam i ri nga mosha, por kam përjetuar luftën si të
6 tjerët. Isha 6 vjeç gjatë luftës në atë kohë. Unë, familja ime
7 dhe qytetarët e tjerë jemi detyruar të lëshojmë apartamentin
8 tonë, shtëpinë tonë. U detyruam që të shkojmë në Shqipëri.

9 "Ajo që po të them tani është më e lehtë sesa ato që mund
10 të thonë të tjerët. Si 6-vjeçar mu desh të ecja drejt
11 Shqipërisë pa ushqim dhe duke parë trupat e viktimave serbe që
12 ishin në rrugë. Dhe kjo është për një 6-vjeçar, është e
13 tmerrshme. Është një temë që e kemi diskutuar çdo ditë dhe
14 është çështje, të cilën mendojmë se është në interes të
15 publikut."

16 Për sa i përket emrave të, në mënyrë të veçantë për sa i
17 përket emrit të kryetarit të grupit të punës që u botua në
18 tërësinë e saj, po të shohim rreshtin 11 të T1604 të
19 transkriptit.

20 Ta zvogëlojmë që i gjithë materiali të shihet në ekran.
21 Ndoshta ishte gabim. Faqen tjetër ju lutem. Është faji im,
22 është T1605, rreshti 11.

23 Kur e pyetën, për sa i përket emrave të kryetarit të
24 grupit të punës për shembull. Ai tha që:

25 "Ishte në interesin e publikut për ta bërë një gjë të

1 tillë përse këta persona ishin zyrtarët e lartë serbë dhe janë
2 persona, të cilët një pjesë e popullatës së Kosovës i ka
3 njohur për shkak të deklaratave që kanë dhënë. Këta nuk ishin
4 persona privatë. Duke qenë që ata janë përmendur në këto
5 dokumente ne e menduam të nevojshme që identiteti i tyre të
6 shfaqej.”

7 Dhe kur e bëri një gjë të tillë, ai duke nxjerrë
8 informacion sekret të paautorizuar të procedurave gjyqësore,
9 ai nuk bëri vepër penale. ZPS-ja është dakord dhe ne jemi
10 dakord. Dhe ai nuk ka bërë vepër penale kur ka botuar në
11 mënyrë të paautorizuar identitetin e të dhënave personale të
12 personave, të dëshmitarëve të mbrojtur dhe këtë e ka bërë
13 online. Këtë, me këtë është dakord ZPS-ja dhe ne.

14 Këta janë katër artikuj, të cilët e kanë ruajtur
15 konfidencialitetin e informacionit sensitiv. Z. Berisha kështu
16 ka pohuar.

17 Të shohim tani provën P129-ET. Në faqen e dytë. Ta
18 zmadhojmë. Paragrafi i fundit.

19 Më 9 shtator, në këtë artikull, z. Berisha thotë që
20 artikujt e botuar të hënën kanë ruajtur konfidencialitetin pa
21 nxjerrë emra, materiale sensitive që përmbahen në këto
22 dokumente. Dhe ne jemi dakord. Dhe ZPS-ja është dakord po
23 kështu.

24 Në faqen 3. Në këtë artikull në *inFokus*, në fund të faqes
25 përmenden artikujt e botuar më datën 7 shtator, të cilët janë

1 botuar pa dhunuar informacionin me ndjeshmëri të lartë. ZPS-ja
2 është dakord dhe unë jam dakord.

3 Që redaktimi i këtyre artikujve me redaktimet e vogla për
4 sa i përket numrit të çështjeve dhe emrave të personave
5 privatë. Ndërkohë që botimi i pjesës tjetër, kërkesat e bëra
6 dhe identitetet, funksionet zyrtare të zyrtarit e MUP-së në
7 Jagodinë në kërkesën për bashkëpunim 120 dhe emrin e shefit
8 apo kryetarit të grupit të punës të Komitetit Serb për Kosovën
9 dhe Metohinë, siç e quanin ata. Nuk përbëjnë shkelje të
10 informacionit me ndjeshmëri të lartë dhe ne jemi dakord me
11 këtë.

12 Ashtu si z. Berisha, dhe z. Gucati ka lejuar që vetëm
13 anëtarët e shtypit t'i përdorin këto dokumente. Në paragrafin
14 66 ZPS-ja, të dosjes së tyre përfundimtare, ZPS-ja thotë që
15 anëtarë të tjerë, njerëz të tjerë përveç anëtarëve të shtypit
16 kanë patur mundësi në këtë ndërtesë dhe mund t'i kenë parë
17 këto dokumente. Kjo nuk ka asnjë -- nuk ka asnjë provë që të
18 provojë që anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të shtypit të
19 mund të kenë patur qasje në këto dokumente. Në paragrafin 44
20 të dosjes së tyre përfundimtare, ZPS-ja e pranon dhe citoj që
21 "gjatë kohës së aktakuzës dhe dëshmisë së tyre, i akuzuari ka
22 thënë që nuk i kemi dhënë këto emra dhe i kemi dhënë medias që
23 të bëjë të njëjtën gjë," dhe ka përshkruar këtë qëndrim si
24 sofizëm apo mohim i realitetit apo në fund kur thotë që është
25 çështje e interpretimit semantik. Nuk është sofizëm as

1 semantikë për të bërë ndryshime midis lejimit të qasjes për
2 dokumente të paredaktuara për anëtarët e medias profesioniste
3 që kanë detyrimet e tyre profesioniste dhe në të njëjtën kohë
4 për të ngulur këmbë që nuk kanë botuar emrat e dëshmitarëve.
5 Kjo është një qasje apo dallim që bën edhe z. Berisha. Është
6 një ndryshim apo dallim që e ka bërë në mënyrë të ligjshme z.
7 Berisha. Dhe siç mund t'i kujtohet Trupit Gjykses dhe znj. Ana
8 Majers që ka bërë të njëjtën gjë, kur bëri ndryshim midis
9 opsionit bërthamor të nxjerrjes së plotë të dokumentacionit në
10 vend që të shkojnë dhe t'ia japin gazetarëve. Siç e tha ajo,
11 shtypi ka detyrat e tyre për sa i përket konfidencialitetit
12 dhe këto janë të mirëpërcaktuara dhe kjo është pjesë e mënyrës
13 së të kuptuarit të detyrës së tyre. Ky është qëndrimi, ky
14 është ndryshimi që ka vendosur apo ka bërë z. Gucati dhe z.
15 Haradinaj në fakt.

16 Dhe në materialin, të shohim tani materialin Pl-ET.
17 Transkripti i konferencës së parë të shtypit më duket në faqen
18 4, në 00:00:43 sekonda - në faqen tjetër ju lutem.

19 Prisni një çast ju lutem. Edhe i kthehem faqes 4 dhe
20 njëherë. Në fakt kisha të drejtë. Në pjesën 9 minuta e 43
21 sekonda, paragrafi i fundit, rreshti i dytë, do të shihni aty
22 të nderuar Gjykatës, z. Haradinaj në praninë e z. Gucati tha
23 qartë që:

24 "Ne nuk do ta marrim këtë material dhe ta nxjerrim në
25 rrugë."

1 Atë po jua vinin në dispozicion anëtarëve të shtypit, por
2 nuk po e nxirrnin në rrugë, kështu thanë.

3 Në faqen tjetër 11:21, gazetari që përmendet këtu, i
4 kërkoi z. Haradinaj që të lexonte në publik, nëse duket,
5 emrat. E kjo shihet nga pyetja që vijon në komentet e
6 mëhershme të z. Haradinaj dhe z. Haradinaj kësaj ftese që i
7 bën gazetari i përgjigjet:

8 "Jo. Ata që i kanë lejuar këto materiale që të nxirren
9 duhet ta dinë një gjë të tillë."

10 Të nderuar Gjykatës, i shikoni këto, të gjitha materialet
11 dhe i shikoni në kontekstin e duhur dhe unë jam dakord me
12 këtë. Por ju kërktoj të nderuar Gjykatës, që materialet t'i
13 shikoni në kontekstin e tyre dhe jo në mënyrë përzgjedhëse dhe
14 kur t'i shqyrtoni këto materiale në kontekstin e tyre do të
15 vëreni deklaratën e qartë të z. Haradinaj që:

16 "Këto materiale nuk do t'i nxjerrim në rrugë."

17 Dhe këtë nuk e kanë bërë. Dhe kur gazetari i kërkoi që të
18 lexonte me zë të lartë emrat e dëshmitarëve, ai tha:

19 "Jo. Ata të cilët i kanë lejuar që këto dokumente të
20 nxirren duhet ta dinë një gjë të tillë," por ai nuk do të
21 lexonte emrat e dëshmitarëve.

22 Është pra në këtë mënyrë ishte duke përsëritur të njëjtin
23 dallim që ka bërë z. Berisha. Lejimin që anëtarët e shtypit të
24 përdorin dokumentet e paredaktuara dhe për të botuar
25 materialin publik, pra dallimin midis personave publikë si

1 zyrtarët serbë dhe personat privatë.

2 Në konferencën e dytë të shtypit kur të shikoni provat,
3 të gjithat provat, të nderuar Gjykatës, dhe kontekstin rreth
4 tyre - le t'i hedhim një sy provës materiale P2-ET dhe do të
5 shihni se çfarë tha z. Haradinaj për sa i përket sugjerimit të
6 frikësimit.

7 Në faqen e katërt.

8 Ai iu drejtua që mund të mendonin për të frikësuar dikë.

9 Në paragrafin e pestë:

10 "Ata që mendojnë për të frikësuar dikë ne i kemi dosjet,
11 emrat e tyre. Ata janë anti-nacionalistë, janë njerëz të cilët
12 nuk e duan Kosovën."

13 Kjo ishte përgjigjja e tij ndaj sugjerimit të atyre që
14 mendonin që do të bëhej frikësim, pra që ata do të ishin
15 personat të cilët ishin kundër Kosovës, nuk e donin Kosovën.
16 Z. Gucati vazhdimisht dhe z. Gucati dhe z. Haradinaj dhe z.
17 Gashi po ashtu i kanë kërkuar gjithnjë shtypit që të mbronte
18 emrat e dëshmitarëve që shfaqeshin në këto dokumente të cilat
19 i janë lejuar shtypit t'i shfrytëzojë.

20 Të shohim në P2-ET [sipas përkthimit], në faqen 9, në
21 paragrafin e katërt të faqes 9, z. Gashi në praninë e z.
22 Gucati i drejtohet medias dhe thotë, në fund të atij paragrafi
23 që:

24 "Edhe në qoftë se keni ardhur dhe i keni këto dokumente,
25 është ndaluar rreptësisht që të botohen emrat e

1 dëshmitarëve...”

2 Shtypi, sipas nesh duhet të botonte vetëm ato të cilat
3 ishin në gjendje t’i botonin apo duhej të botonin.

4 Në faqen 12 tani [sipas përkthimit].

5 Në faqen 3 nga 7 faqe, pas 00:07:19 z. Gashi në praninë e
6 z. Gucati përsëriti që:

7 “Të gjithë përfshirë kryetarin dhe të tjerët i kanë thënë
8 gjithmonë që ata që kanë qasjen e këtij dokumenti që ndodhet
9 në këto dokumente që në qoftë se janë emrat e dëshmitarëve të
10 mbrojtur apo anonimë, këta emra nuk duhet që të botohen.”

11 Dhe e kanë bërë, është e drejtë.

12 Kjo ka ndodhur në P37-ET [sipas përkthimit], z. Haradinaj
13 e përsëriti të njëjtën gjë.

14 Në faqen 12, në 00:23:40, kjo është konferenca e tretë
15 për shtyp, është konferenca e fundit për shtyp, thuhet që:

16 “Sa i takon sugjerimit të medias për botimin e këtyre
17 dokumenteve”

18 Z. Haradinaj thotë:

19 “Çfarë të mundeni.”

20 Kjo në fakt është diçka që është përsëritur sërish në
21 konferencën e tretë, domethënë, ata e kanë bërë të qartë gjatë
22 të gjithë këtij procesi që ne nuk duam ta bëjmë dokumentin
23 publik, nuk duam që dokumentet t’i nxjerrim në rrugë, por po
24 ja vëmë në dispozicion shtypit dhe shtypit i di detyrimet e
25 veta profesionale. Dhe të cilët ashtu siç Halil Berisha i kanë

1 parë dokumentet për të këqyrur çfarë mundnin për të
2 identifikuar ato pjesë që mund të botonin dhe kanë botuar për
3 shembull tre letra plotësisht. Kemi parë një letër të z.
4 Berisha, në përjashtim të redaktimeve të cilat janë vënë vetëm
5 tek emrat e personave privatë. Pra duke bërë këtu dallimin
6 ndërmjet dokumenteve të cilat janë shënjuar si konfidenciale
7 dhe atyre që nuk janë shënjuar konfidenciale, ndërmjet
8 informacionit që ishte konfidencial në përbërje të dokumenteve
9 dhe informacionit jokonfidencial; dhe z. Haradinaj e përsërit
10 sërish pozicionin e tij këtu edhe në konferencën e fundit për
11 shtyp.

12 Në marrjen në pyetje të z. Gucati, z. Gucatit, iu bënë
13 pyetje lidhur me një shkëmbim të më vonë, domethënë në fund
14 fare të periudhës së aktakuzës që kishte të bënte me
15 diskutimet për veteranët e rremë. Këtë mund ta shohim në
16 dokumentin P35-ET, faqja 13.

17 Shkëmbimi fillon - pra shikojmë z. Haradinaj domethënë në
18 qoftë se gazetari thotë që, a sugjeroni që të mund të vijohet
19 me botimin e dokumenteve, z. Haradinaj thotë që, vetëm në
20 qoftë se mundeni, vazhdoni me botimin. Dhe ndërkohë që z.
21 Gucati në fund fare të faqes thotë tek 00:25:55 [sipas
22 përkthimit], që duhet mbrojtur privatësia e personit. Nuk e di
23 në qoftë se mund ta lexoni këtë apo jo.

24 Dhe kemi këtu edhe diskutimin që u bë për veteranët e
25 rremë. Në parashtrimet tona ZPS-ja e ka keqinterpretuar

1 atëherë çfarë ka thënë z. Gucati lidhur me këtë gjë. Le të
2 vijojmë me faqen tjetër. Mund të shohim këtu që z. Gucati siç
3 e ka bërë që nga fillimi, e fton shtypin që të lexojë
4 dokumentet. Ai nuk thotë që të botohen emrat. Ai çfarë thotë,
5 çfarë thotë z. Gucati për sa i takon veteranëve të rremë është
6 që ai kritikon shtypin për botimin e të ashtuquajturve
7 veteranë të rremë dhe siç e ka thënë dhe z. Gucati në situata,
8 të cilat janë provokuar prej tyre.

9 Është thënë që në fillim fare se të gjitha shkëmbimet e
10 tjera dhe ky shkëmbim dhe të gjitha pjesë të procesverbalit të
11 dokumenteve, të cilat unë i kam përmendur, shpresoj dhe
12 mendoni që ju të nderuar Gjykatës do i lexoni të gjitha ato
13 dhe t'i vendosni në kontekst në mënyrë që të mund të bëni një
14 vlerësim të drejtë të provave dhe jo që të përqendroheni në
15 mënyrë selektive vetëm tek ato pjesë të cilat konsiderohen si
16 të rëndësishme nga ZPS-ja.

17 Dhe parashtroj që kur të shikoni të gjithë provat do
18 shikoni që këto prova janë konsistente nga fillimi deri në
19 fund dhe bëhen të njëjtat dallime që ka bërë dhe z. Berisha
20 para nesh domethënë versionin e vënies në dispozicion të
21 dokumenteve jo të redaktuara për shtypin në mënyrë që ata të
22 mund të shikonin dhe të bënin vlerësimin e tyre etik dhe
23 profesional lidhur me të; të shikonin se cili ishte
24 dokumentacioni që ishte shënjuar si konfidencial dhe jo dhe
25 duke parë këtu edhe përmbajtjen për të ditur në qoftë se

1 përmbajtja kishte natyrë konfidenciale ose nuk kishte natyrë
2 konfidenciale dhe të shikoni në qoftë se personat ishin
3 persona publikë të tillë si për shembull zyrtarët serbë apo
4 persona privatë dhe kanë bërë të njëjtat vlerësime që ka bërë
5 dhe z. Berisha me të drejtë për botimet e plota të dokumenteve
6 të letrave që përmendëm më sipër në përjashtim të redaktimit
7 të identitetit të personave privatë.

8 Mënyra sesi e kupton z. Gucati ligjin, ne parashtrojmë,
9 është konsistente, ka vijimësi nga fillimi deri në fund. Është
10 po ashtu në përputhje me perceptimin e z. Berisha. Dhe duket
11 që ka një lloj kontradikte ose jo konsistence, pra duket që
12 kjo mungesë konsistence ose kontradikte ekziston nga ana e
13 ZPS-së lidhur me pozicionin e Halil Berishës.

14 Në faqen, në provën materiale P2-ET. Në faqen 4 të
15 dokumentit prej 11 faqesh.

16 Kjo është konferenca e dytë për shtyp. Dhe kjo është në
17 përputhje me atë çfarë thuhet, çfarë është thënë në
18 konferencën e parë për shtyp, që në këtë fazë OVL-ja e UÇK-së
19 ka marrë edhe opinion juridik. Në qoftë se do të shohim
20 paragrafin e dytë të kësaj faqeje, sërish z. Haradinaj në
21 praninë e z. Gucati pra thotë që:

22 "...e kemi diskutuar me juristin tonë dhe mendojmë që
23 është e dënueshme në qoftë se ne nuk përmendim emrat. Ne nuk
24 po përmendim emra dhe "përderisa Holanda nuk ka përmendur
25 emra."

1 "...po ja ku janë. Nuk po përmendim asnjë emër. Këtu janë
2 dokumentet. Unë nuk mendoj që është vepër penale që të
3 nxjerrësh emrat e personave zyrtarë. Flasin për Shuendimen dhe
4 të tjerët domethënë nuk flasin për persona privatë, po flasin
5 për persona që mbajnë poste zyrtare."

6 Pra është i njëjti dallim që ka z. Berisha, dallimi
7 ndërmet personave që janë persona publike, pra që mbajnë
8 pozicione publike dhe personat të cilët janë persona privatë,
9 domethënë edhe në këtë rast bëhet i njëjti dallim ashtu edhe
10 siç ka bërë edhe z. Berisha.

11 Ditën e nesërme z. Gashi përsëriti sërish në prani të z.
12 Gucati.

13 Ju lutem shfaqni në ekran provën P4-ET, ju lutem. Në
14 faqen 2. Në qoftë se do të zbresim pak më poshtë në faqe
15 atëherë tek pjesa 00:04:00, tek rreshti 3, z. Gashi thotë:

16 "Botimet e këtyre dokumenteve nuk janë të ndaluara fare.
17 Mirëpo ju duhet të keni parasysh që nëse gjeni në këto
18 dokumente emra, mbiemra dhe të dhëna të tjera të dëshmitarëve,
19 nuk mundeni në asnjë mënyrë që t'i bëni publike, por nuk është
20 e ndaluar që të publikoni relacione që i kanë pasë zyrtarët e
21 Prokurorisë Speciale të Gjykatës Speciale apo çfarëdolloj
22 institucioni tjetër me organet e ndjekjes së Serbisë."

23 Është egzaktesisht i njëjti dallim që ka bërë dhe z.
24 Berisha, domethënë dallimi ndërmjet gjërave apo dokumenteve që
25 ishin konfidenciale dhe nuk ishin konfidenciale. Dallimet

1 ndërmjet personave publikë që mbanin pozicione zyrtare dhe
2 personave privatë. Këshilla e dhënë nga z. Tomë Gashi, jurist
3 në OVL-në e UÇK-së vazhdon më tej. Mendoj në faqen tjetër. Në
4 fakt në qoftë se do t'i kthehemi sërish faqes së mëparshme, në
5 fund fare të asaj faqeje - ju lutem ndaloheni atje. Dhe fjalia
6 e fundit këtu thotë që:

7 "Duhet të jeni shumë të kujdesur" i drejtohet medias "që
8 të mos botoni emrat e personave të cilët janë përmendur në
9 dokumente sepse kjo është e dënueshme dhe e paligjshme.
10 Megjithatë jeni të lirë që të botoni ndërmjet shkëmbimeve
11 ndërmjet zyrtarëve."

12 Dhe ky është egzaktesisht që ka botuar për shembull z.
13 Berisha. Pra nuk është se ai e ka marrë këtë këshillim nga z.
14 Gashi, po kjo është qasja që e ka përçafuar ai. Kjo është
15 qasja që kanë shprehur të dy, edhe z. Gucati edhe z. Haradinaj
16 në konferencën e parë. Kjo është qasja që kanë rishikuar edhe
17 në konferencën e dytë dhe është konfirmuar sërish një ditë
18 pastaj konferencës së dytë siç është shprehur nga z.
19 Haradinaj. Dhe në faqen 7 përsëri z. Gashi komenton. Në fund
20 të paragrafit që mban këtë kohën 00:14:32 thuhet që:

21 "Nuk është e ndaluar që të botohet komunikimi midis
22 institucioneve por në asnjë mënyrë në qoftë se gjeni emra të
23 dëshmitarëve, të lutem i fshini ato dhe mos i publikoni sepse
24 është e ndaluar."

25 Dhe në qoftë se do shohim provën P70 [sipas përkthimit].

1 Kjo është data 18. Ju lutem të shkojmë tek faqja e 15-të e 19
2 faqeve të dokumentit. Nën 00:25:39, pra kemi praninë e z.
3 Haradinaj dhe z. Gucati. Megjithatë çfarë thotë z. Gashi është
4 në përputhje me të gjitha këshillat e tjera që ai ka dhënë dhe
5 më parë. Dhe njëherë nga dita e parë z. Haradinaj dhe z.
6 Gucati kanë përqaftuar të njëjtën qasje siç ka shpalosur dhe z.
7 Berisha këtu te shtypi.

8 "Dhe kemi thënë edhe herë të tjera e kemi lexuar,
9 megjithatë thuhet që nëse institucionet, p.sh. Prokuroria e
10 Krimeve të Luftës në Beograd i ka emrat siç është në dy raste.
11 Kryeprokurorit ia kemi mësuar emrin përmendësh, shkak
12 komunikata zyrtare që organizata ka ardhur në posedim,
13 Organizata e Veteranëve të UÇK-së në dy raste dhe nuk është e
14 ndalume me i publiku. Por jo të publikohen dëshmitë e
15 dëshmitarëve sepse ajo është e dëmshme. Nuk ka çka me thënë
16 tjetër."

17 Sërish domethënë bëhet dallimi ndërmjet informacionit që
18 është konfidencial dhe jokonfidencial dhe sërish në këtë pjesë
19 z. Gashi flet për dëshminë e dëshmitarëve dhe nuk sugjeron që
20 këto dëshmi të botohen nga të gjithë. Sërish bëhet dallimi
21 ndërmjet personave të cilët janë persona publikë dhe persona
22 zyrtarë, persona zyrtarë që janë persona të prokurorisë e të
23 tjerë. Dhe sipas mendimit të z. Gashi është bërë egzaktesisht
24 i njëjti dallim ndërmjet bërjes, vënies në dispozicion të
25 dokumenteve për anëtarët e shtypit, sepse pa diskutim që ata

1 kanë dhe detyrimet etike dhe profesionale për të bërë
2 vlerësimin e tyre dhe nga ana tjetër elementit të botimit të
3 dokumenteve online nga shtypi.

4 Kuptimi i ligjit ose kuptimi i ligjit nga z. Gucati është
5 në pajtim dhe theksohet, ritheksohet nga mënyra sesi ka
6 vepruar shtypi, si ka vepruar z. Berisha dhe kolegë të tjerë
7 të tij. Nuk është e nevojshme që të kalojmë së bashku të
8 gjithë artikujt e shtypit por egzaktesisht e njëjta qasje
9 është përdorur dhe nga anëtarë të shtypit të organeve të tjera
10 të shtypit si *NewBorn* etj. Siç është informuar pas konferencës
11 së parë për shtyp dhe pastaj këshillimit ligjor të z. Gashi
12 dhe e dimë që Prokuroria në dosjen e saj i referohet një
13 përgjigje të z. Gucati që i referohet konferencës së dytë të
14 shtypit dhe ku njohin që është emëruar, ku është caktuar z.
15 Gashi, por ata injorojnë provat e mëparshme që thonë që "ai ka
16 qenë i përfshirë që më përpara."

17 Për shembull në qoftë se do të shikojmë transkriptin
18 T2389, në rreshtin 11 ku thuhet që:

19 Ai ka qenë në kontakt me z. Tomë Gashi në debatet
20 televizive. Dhe z. Tomë Gashi ka shprehur mendimin e vet
21 përpara sesa të bëhej, përpara kësaj -

22 Dhe për shembull në qoftë se do të shikojmë faqen tjetër
23 T2393, Në rreshtin 15, z. Gucati ka thënë që në fakt ai ka
24 autorizuar z. Tomë Gashin që pas konferencës së parë për
25 shtyp.

1 "Dhe më pas ne e kemi marrë atë në punë si avokatin
2 tonë."

3 Dhe kjo është në përputhje me atë çfarë unë thashë më
4 përpara dhe që është marrë këshillimi i avokatit përpara
5 konferencës së dytë.

6 Është e dallueshme nga parashtrimi i provave nga ZPS-ja
7 që kur për shembull një dëshmitari ZPS-së shpreh konfuzion për
8 shembull për përcaktimin e kronologjisë së ngjarjeve ose për
9 shembull kur thonë që nuk e mbaj mend se kur ka ndodhur X
10 ngjarje gjatë konferencës së dytë ose së tretë, kjo nuk është
11 e rëndësishme për ta. Ndërkohë që kur bëhet fjalë për të
12 njëjtin vlerësim nga ana e Mbrojtjes, në qoftë se ka mungesë
13 konsistence ose mungesë kronologjie në një moment të caktuar
14 kjo shikohet si me domethënie të madhe. Siç e thashë dhe në
15 fillim, nuk kam pikë dyshimi që Trupi Gjykses do të aplikojë
16 të njëjtat standarde si në rastin e Mbrojtjes ashtu edhe në në
17 këtë rastin e Prokurorisë.

18 Po sa herë jepen këshillat, kjo përforcon atë që kuptonte
19 z. Gucati që në fillim, po kështu edhe z. Haradinaj dhe këtë
20 kishin bërë gjatë konferencave të shtypit dhe këtë sqaroi edhe
21 z. Berisha. Dhe ky kuptim i ligjit është ai që ata iu
22 përmbajtën dallimeve të cilat përmendi z. Berisha dhe në qoftë
23 se i përmbahesh atyre nuk kryhet vepra penale e zbulimit të
24 paautorizuar të informacionit sekret. Dhe nuk bëhet vepër
25 penale në qoftë se bëhet zbulim i paautorizuar i identiteteve

1 të personave dhe/apo të dhënave të tyre personale të
2 dëshmitarëve të mbrojtur. Siç tha edhe Prokuroria dhe ne jemi
3 dakord me këtë.

4 ZPS-ja mbështetet shumë në dy urdhrat që u janë dhënë
5 OVL-UÇK-së, një prej të cilave nuk iu dha Hysni Gucatit.
6 Ndërsa i dyti iu dha Hysni Gucatit. Që të dy janë dhënë vetëm
7 në anglisht, pa përkthim në shqip. Përkthimi në shqip është
8 bërë i disponueshëm shumë më vonë.

9 Dhe të sugjerosh, siç sugjeron Prokuroria që z. Gucati
10 flet anglisht është një interpretim i gabuar i fakteve. Ajo që
11 ka thënë z. Gucati në T2169. Kjo është në rreshtin 23 dhe kjo
12 është referenca në të cilën mbështetet Prokuroria.

13 Ta kontrolloj pak numrin e faqes? 2169.

14 Shikohet aty që thuhet:

15 "A flisni anglisht?"

16 "Jo, nuk flas. ...Nuk e flas anglishten."

17 Pastaj ka edhe një referencë tjetër më vonë, në të cilën
18 mbështetet Prokuroria dhe atij i bëhet pyetja:

19 "A lexoni anglisht?"

20 Dhe përgjigjja është:

21 "T'ju them të vërtetën, jo. Shumë pak ose pothuajse
22 fare."

23 Dhe mbi këtë mbështetet Prokuroria për të thënë që ai di
24 të lexojë dhe mund t'i lexonte dhe t'i kuptonte këto urdhra,
25 ky pretendim i Prokurorisë është i ekzagjeruar.

1 Ata nuk thonë që ishte kryer ndonjë vepër penale përmes
2 asaj që ndodhi më 7 dhe 16 shtator. Ata nuk u arrestuan për
3 ndonjë gjë në lidhje me ato dy konferenca shtypi. Dokumentet
4 që e dinë se janë lënë gjatë natës në zyrat e OVL-UÇK-së
5 pastaj konferencës së parë dhe të dytë për shtyp. Nuk ka
6 nevojë të hymë në hollësi se çfarë u tha aty në ato konferenca
7 shtypi por ishte e qartë që u përmendën komunikimet zyrtare
8 midis Serbisë dhe zyrtarëve të ZPS-së në lidhje me hetimet.
9 Dhe në konferencën e parë për shtyp u përmendën zyrtarët serbë
10 që ZPS-ja e dinin në atë kohë dhe urdhri u morr pas
11 konferencës së parë për shtyp, por nuk janë përmendur emrat e
12 dëshmitarëve, as persona privatë. Pra nëse ose në masën që u
13 kuptuan këto urdhra, ato përforconin atë mënyrë sesi e
14 kuptonte ligjin z. Gucati në atë kohë. Në fakt atyre iu tha
15 kjo gjë, pra iu tha që - u pranua nga ZPS-ja që ata nuk kishin
16 nxjerrë emra dhe u falënderuan për këtë.

17 Në provën materiale 1D3-ET, në deklaratën e z. Gucati,
18 paragrafi 39, kjo është hera e parë që z. Gucati kishte folur
19 me një zyrtar nga ZPS-ja në lidhje me këtë.

20 Pra a mund t'i jap emrat e punonjësve?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo. Nuk mund
22 t'i jepni.

23 Z. REES: [Përkthim] Atëherë ta bëj kështu. Ju të nderuar
24 Gjykatës e mbani mend që ka qenë ky oficeri suedez dhe do ta
25 quaj oficeri suedez dhe do të përmend oficeri tjetër që jepet

1 me iniciale. Pra i pari është A, i dyti është B.

2 I pari nuk fliste, A-ja nuk fliste shqip dhe nuk tha
3 asgjë gjatë atij bashkëbisedimi midis oficerit B dhe anëtarëve
4 të OVL-UÇK-së. Oficeri A tha se nuk kishte kuptuar se çfarë po
5 thuhej. Dhe ju kujtohet që Oficeri B nuk u dha, nuk u thirr
6 për të dhënë dëshmi, megjithëse ne i kërkuam Trupit Gjykues që
7 ai të vinte të jepte dëshmi, por u refuzua për arsye që nuk
8 mund t'i shpjegojmë.

9 Pra ne nuk kemi dëgjuar këtu se çfarë kishte për të thënë
10 Oficeri B. Pra Oficeri B tha se ai kishte ndjekur lajmet dhe e
11 falënderoj z. Gucati që nuk nxori asnjë emër. E tha këtë edhe
12 herën e dytë dhe herën e tretë kur erdhi për të marrë dosje.
13 Pra ai tha që:

14 "Është mirë...që keni bërë mirë që nuk i keni përmendur
15 këto emra në publik."

16 Pra këtë ja u tha ZPS-ja dhe kjo përforcoi të kuptuarit
17 prej tij të ligjit. Të njëjtën të kuptuar të ligjit kishte
18 edhe z. Berisha që u përforcua kur ata morën këshilla ligjore
19 që ishte pikërisht e njëjta gjë, që të bëhej dallimi midis
20 dokumenteve që ishin konfidenciale dhe jo, të atyre që ishin
21 shënuar si konfidenciale dhe atyre jo. Ka një dallim atyre
22 gjërave që iu dhanë shtypit dhe ato që u bënë publike online
23 që t'i shikonite publiku. Dhe po kështu edhe dallimi midis
24 personave publikë si zyrtarët serbë që nuk u përmendën në
25 konferencën e parë të shtypit dhe siç e tha, siç e vërtetoi

1 edhe Oficeri B dhe personave që ishin privatë dhe që ishin
2 dëshmitarë të mbrojtur, emrat e të cilëve nuk u përmendën.

3 Dhe ata nuk i thanë z. Gucati as herën e parë as herën e
4 dytë që kishin kryer vepër penale.

5 Po të shikojmë P4-ET, në faqen 8.

6 Në 00:17:21, kjo është konferenca e shtypit, mbas
7 konferencës së shtypit më datë 17, ku oficerja nuk fliste
8 shqip dhe kishte shkuar atje dhe konfirmoi atë që pyeti
9 gazetari:

10 "...a thanë që është e mundur që të jenë bërë vepra
11 penale..."

12 Dhe z. Gucati u përgjigj:

13 "Jo. Nuk ma thanë këtë."

14 Dhe z. Gashi, i cili foli me Oficerin B në këtë fazë. Të
15 kalojmë tek faqja 9, paragrafi i dytë. Këtu po flet për
16 kontaktet që ka pasur me Oficerët A dhe B.

17 "Nuk u bisedua që ishte bërë ndonjë krim nga OVL-UÇK-ja
18 sepse ata nuk kishin kryer ndonjë krim."

19 Z. Gashi konfirmoi se kur ishin Oficerët A dhe B, B-ja
20 foli në shqip. Dhe ai nuk tha që ishte kryer ndonjë vepër
21 penale. Kjo përforcon si e kanë kuptuar ata ligjin dhe në këtë
22 fazë - po themi atë që e bëri të qartë ZPS-ja për z. Berisha
23 që z. Berisha nuk kishte kryer ndonjë vepër penale.

24 Por pas kësaj bisede, pas konferencës së parë dhe të dytë
25 për shtyp përforcoi atë që dinte dhe kuptonte z. Gucati dhe

1 ishte kjo mënyra sesi reagoi edhe shtypi. Këtë të kuptuar të
2 ligjit përforcoi kjo dhe veprimet e z. Gucati janë plotësisht
3 në përputhje me këtë të kuptuar të ligjit.

4 Kisha ndërmend që ju të nderuar Gjykatës, të thoja që
5 juve të nderuar Gjykatës që të shikoni 14 emra, sepse këta
6 janë përmendur në tre konferencat për shtyp. Dhe këtë do të
7 bëj duke iu referuar dosjes përfundimtare dhe do t'i gjej aty
8 ku janë provat materiale në mënyrë që t'i shikoni ju.

9 Pra janë përmendur emra në konferencën e parë për shtyp.
10 Këta ishin të gjithë zyrtarë serbë. Po të shikojmë P1-ET. Të
11 nderuar Gjykatës shikoni në fund të faqes 1, në faqen 2.

12 Po këtu z. Haradinaj që përmend në paragrafin e dytë një
13 emër që unë sapo e thashë.

14 A mund ta përmend atë emër i nderuar Gjykatës?

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk mund
16 ta përmendni emrin. Ne e lexojmë vetë këtu.

17 Z. REES: [Përkthim] Ka dy emra këtu. Njëri është ish-
18 Prokuror i Krimeve të Luftës Serb, një emër që e dinë mirë të
19 gjithë në Kosovë dhe i dyti është Kryetari i Grupit të Punës
20 të Komitetit për Kosovën e Metohinë në Serbi. Pra përsëri
21 zyrtarë publikë. Pastaj në fund të paragrafit përmendet një
22 Prokuror i Serbisë. Ju e shikoni aty. Më tej, në faqen tjetër,
23 në mes të kësaj faqe - t'i numërojmë paragrafët - a mund ta
24 shikojmë të gjithë faqen të plotë? Në paragrafin e pestë,
25 është emri i një personi që ka vdekur tashmë.

1 A mund ta përmend këtë emër?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka nevojë
3 ta përmendni sepse mund t'i lexojmë vetë.

4 Z. REES: [Përkthim] Po, ai ka vdekur. Nuk është më
5 gjallë. Dhe nuk e di që të jetë emër konfidencial apo që të
6 jetë vendosur si i tillë.

7 Të vazhdojmë në faqen tjetër. Në faqen tjetër. Tjetrën.
8 Faqen tjetër. Faqen tjetër ju lutem. Faqen tjetër. A vazhdoni
9 të shkoni më poshtë ju lutem. Ky është fundi i faqes, fundi i
10 dokumentit.

11 A mund të shkoni në krye të dokumentit. Kaloni pak më
12 poshtë. Këtu kemi versionin e redaktuar. A mund të na nxirrni
13 versionin e paredaktuar, versionin e plotë? Faleminderit. Të
14 lutem kaloni poshtë në faqet e tjera. Ndaloni pak këtu.

15 Pamë në paragrafin 2 tre emra që nuk janë redaktuar, nuk
16 janë hequr. Pastaj është një emër tjetër që është hequr. Po
17 këtu e shikoni versionin të paredaktuar, pra katër emra u
18 bënë.

19 Pastaj nëse kalojmë më poshtë, tre paragrafë më poshtë
20 janë dy emra të tjerë - më falni - një, ish-Shefi i Policisë
21 së Prizrenit.

22 Paragrafi vijues. Është Shefi i Policisë së Mitrovicës.

23 Pastaj edhe dy të tjerë në paragrafin vijues. Emri i
24 nëntë është në paragrafin që fillon me: "Ata pastaj kanë
25 bashkëpunuar."

1 Dhe këtu përmenden Shefi i Policisë në Ferizaj.

2 Pra që në fillim janë përmendur këtu nëntë në konferencën
3 e parë. Të gjithë këta janë zyrtarë serbë dhe kjo është në
4 përputhje me atë dallime që bëri z. Berisha. Në fakt vetë z.
5 Berisha bëri publike dy prej atyre emrave në artikujt që i
6 pamë. Pra nëntë.

7 Në konferencën e dytë për shtyp, vetëm dy emra janë
8 përmendur. Që të dy zyrtarë serbë, njëri prej të cilëve u
9 përmend edhe në konferencën e parë. Pra është përmendur vetëm
10 një emër shtesë.

11 Dhe po të shikojmë pastaj transkriptin e konferencës së
12 dytë për shtyp që është P2-ET.

13 Në faqen e parë përmenden dy emra në konferencën e parë
14 të shtypit nga z. Gucati. Në konferencën e parë z. Haradinaj
15 në fakt i ka përmendur emrat e zyrtarëve serbë në praninë e z.
16 Gucati. Në konferencën e dytë të shtypit, z. Gucati i ka
17 përmendur të dy emrat e zyrtarëve serbë. Një nga ata, është
18 një emër i përmendur edhe në rastin e parë. Shikohet në
19 paragrafin e tretë nga fundi. Zëvendësprokurori i Gjykatës
20 Speciale në Serbi dhe emri i dhjetë është në paragrafin e dytë
21 nga fundi, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë në Serbi, anëtar
22 i MUP-it. Emri i dhjetë i një zyrtari serb.

23 Këta emra janë përmendur në konferencën e parë për shtyp,
24 në të dytën dhe të gjithë janë në përputhje me atë dallimin që
25 ka bërë z. Berisha mes personave publikë si zyrtarët serbë dhe

1 ata që janë persona privatë. Z. Gucati e ka konfirmuar këtë të
2 kuptuar të ligjit që po e zbatonte pikërisht mbi këto baza.

3 Po të shohim tani transkriptin T2192, në rreshtin e dytë.
4 Rreshti 16.

5 Ku flitet për dy zyrtarë serbë në rreshtin 16, ku thotë:

6 "Ne menduam që nuk kemi bërë asgjë për të shkelur ligjin
7 për shkak se ata ishin zyrtarë publikë serbë dhe prandaj i
8 kemi përmendur emrat e tyre."

9 Pra janë edhe dy emra të tjerë, të cilët nuk ika
10 përmendur z. Gucati apo z. Haradinaj, po askush tjetër nga
11 OVL-UÇK-ja. Por që këtë e ka bërë z. Gucati në faqen e tij të
12 Fejsbuk-ut ku ka vendosur një link të një artikulli të gazetës
13 *NewBorn*, ku i kanë referuar dy zyrtarët serbë në numrin 11 dhe
14 12. Në qoftë se këtë e quani nxjerrje nga ana e tij, ndonëse
15 ai vetë nuk është referuar në këtë. Emrat, të cilët i ka
16 nxjerrë *Gazeta NewBorn* në artikullin e botuar online.
17 Artikulli gjendet në referencën e provës materiale P124.

18 Prisni një çast dhe shihni titullin në shqip. Shikoni në
19 titull dhe ju kërkohet ndjesë për shqiptimin. Është fjala
20 "bashkëpunoj" e cila është e vetmja fjalë për dy fjalët në
21 anglisht që janë "kooperim" dhe "kolaborim". Në anglisht në
22 këtë rast është bërë "kooperim" por është e vetmja fjalë që
23 ekziston.

24 Në artikullin në shqip, shihet që është artikulli i
25 *Gazetës NewBorn*. Në faqen e parë është një fotografi të

1 oficerëve të ushtrisë serbe siç shihet nga titulli. Është
2 përmendur këta zyrtarë apo oficerë të ushtrisë serbe dhe aty
3 do të shihet një fotografi e kërkesës së koordinimit 95 e
4 printuar dhe e paredaktuar. Është e vogël aty në ekran, po kjo
5 mund të gjendet ne faqen elektronike. Ky material është i
6 lexueshëm. Është një kopje e plotë e kërkesës për
7 bashkëpunimin numër 95, e paredaktuar dhe botuar në *Gazeta*
8 *Newborn*.

9 Letra nuk ka ndonjë shënim që të jetë konfidenciale.
10 Njoftohet një shtojcë që është konfidenciale, po vetë letra
11 nuk është e shënuar të jetë konfidenciale. Dhe aty përmenden
12 dy zyrtarë ndërlidhës të MUP-it për krime lufte. Dhe në
13 përkthimin anglisht do të shikoni emrat siç i ka publikuar
14 *Gazeta NewBorn* dhe kjo shihet në paragrafin e dytë të
15 artikullit. Pra dy oficerë serbë, të cilët ishin të pranishëm
16 në disa prej masakrave makabre që janë bërë në Kosovë nga
17 regjimi i Millosheviçit. Dhe ne e dimë se kush është personi i
18 vdekur.

19 A mund të shikojmë nëse Sekretarja mund ta zmadhojë
20 letrën?

21 Kjo lexohet lehtësisht në faqen elektronike të gazetës.
22 Dhe kjo në këtë provë shikohet që bëhet fjalë për kërkesën për
23 bashkëpunimin nr. 95 dhe do ta shohim së bashku më vonë. Është
24 botuar e plotë e i njoftohet zyrtarëve të MUP-it të
25 ndërlidhjes. Dhe *Gazeta NewBorn* ka bërë të njëjtin dallim siç

1 ka bërë dhe z. Berisha dhe z. Gucati ka kuptuar këtë që të
2 ishte dhe qëndrimi z. Gashi.

3 Pra e shikojmë këtë dokument. A është dokumenti vetë
4 konfidencial? Shikoni përmbajtjen, a është konfidenciale?
5 Ndryshimi midis personave publikë si zyrtarët serbë.

6 Dhe e kanë botuar këtë letër. Përse? Sepse tregon një
